

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE

NR.7 (361)

KORRIK 2018

ÇMIMI: 30 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA ; Zv/Kryeredaktor: Sakip Cami

Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

10 KORRIKU

NGJARJE DHE DATA


HISTORIA



## NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ

Rrahman PARLLAKU

FAQE 3



## LANÇ, EPOKA MË E NDRITUR NË HISTORINË E SHQIPËRISË

- Sipas kujtimeve të ish-nënkryetarit të OBVL-së Skënder Malindi -

FAQE 4



## E VËRTETA E BETEJËS SË POJSKËS NË VARGJET E PORADECIT

Nga Myfit GUXHOLLI

FAQE 6

## WE ARE NATO – NE JEMI NATO

Halil RAMA

Megjithë mbështetjen e gjerë që gëzon NATO në vendet anëtare, përsëri ka nevojë për një punë më të madhe, sidomos me brezin e ri, për të njohur më mirë vlerat dhe forcën e saj, nivelin e bashkepunimit midis vendeve anëtare dhe përse duhet investuar në fushën e sigurisë dhe mbrotjes. Pikërisht në funksion të këtij qëllimi madhor, në mesin e vitit që kaloi Aleanca Atlantike hapi fushatën për mbrojtjen dhe sigurinë: "WE Are NATO", për të kuptuar më mirë rolin kryesor të saj në të mirë të sigurisë Euro-Atlantike, mënyrën se si përdoret diplomacia, forca ushtarake dhe teknologjia e përparuar për siguri dhe paqe të qëndrueshme.

Ndërkohë, Këshilli Atlantik i Shqipërisë, që nga muaji shkurt i këtij viti e në vazhdim ka ndërmarrë një seri leksionesh publike në shumicën e universiteteve dhe viteve të fundit të shkollave të mesme në të gjithë vendin, si në Tiranë, Korçë, Elbasan, Ersekë, Vlorë, Gjirokastrë, Pogradec, Sarandë, Fier, dhe do të vazhdojë në Shkodër, Kukës, Peshkopi, Mirditë, Burrel etj.

Në këto takime kanë folur personalitete dhe specialistë të spikatur në fushën e sigurisë dhe mbrotjes, nga NATO dhe vendas, ndër të cilët Z. Pears Cazalet, Drejtor i Shtypit dhe Medias në NATO, Dr. Arian Starova, ish Ministër i Punëve të Jashtme dhe President i Këshillit Atlantik, Dr. Dritan Demiraj, ish Ministër i Punëve të Brendshme dhe Komandant në disa misione luftarake të NATO-s në Irak dhe Afganistan, Gjeneral Jeronim Baze, Ish - Shef i Shtabit të Përgjithshëm të FA, Kolonel Kristaq Birbo, ish - Këshilltar i Presidentit të Republikës, Znj. Juxhina Sotiri, Presidente e Rinisë Atlantike, etj.

Theksi është venë kryesisht në vlerat që përfaqëson Aleanca, në organizimin politik dhe ushtarak të saj, në argumentimin se përse NATO është sot realisht organizata politiko – ushtarake më e fuqishme në botë, cilat janë sot rreziqet kryesore për paqen dhe sigurinë me të cilat ndeshet ajo, misionet luftarake të Aleancës, pjesëmarrja e Forcave tona të Armatosura në misionet luftarake të NATO-s etj.

(Vijon në fq.12)

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve

# 24 vjet OBVL



**M**e 18 korrik mbushen 24 vjet nga krijimi i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar. OBVL është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit diktatorial të E.Hoxhës, mohimet dhe politizimet e bëra nga historiografë të atij regjimi, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamerituar.

FAQE 2

SPORT

## Në vazhdim të sagës së "Pasionit të bardhë"

Ende nuk është shuar jehona e aktiviteteve dimërore dhe përshtypjet shumë pozitive të olimpiadës të Koresë, por edhe të shqipëtarëve të cilat na interesojnë të gjithëve, siç ishte kampionati në Shishtavec të Kukësit...

Dr Leonidha Peppo\*

FAQE 10



PROMOVIMI

## Një vlerë e shtuar për historiografinë shqiptare

Prof.ass.dr.Shefqet HOXHA

FAQE 7

STUDIMI

## USHTARAKET DHE TRANZICIONI NE "ZHBERJE E BERJE TE SHTETIT"

Dhimiter Ndrenika

FAQE 6

IN MEMORIAM

## LUFTËTARI MATO MATO, AKOMA NUK KA MARRË STATUSIN E "DËSHMORIT TË ATDHEUT"

Nga Bernard ZOTAJ

FAQE 8

PROFIL

## BURRËRESHA RAMIJE SKUKA, VETERANE E LANÇ-it

Nga Valbona RAMÇE

FAQE 9

HOMAZHE

## LAMTUMIRË MIKU YNË I PAHARRUAR – ARTISTI AGIM KAVAJA

SHPENDI TOPOLLAJ

FAQE 12

PROMOVIMI

## Antologjia e mendimit të sotëm për Mirditën



Nga Xhemal Meçi,

FAQE 11



## PËRVJETORI

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve

# 24 vjet OBVL

Më 18 korrik mbushen 24 vjet nga krijimi i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar. OBVL është një organizatë shoqërore atdhetare. Ajo u formua që të vlerësojë realisht historinë e luftës së lavdishme Nacional Çlirimtare, që të shmangë shtrembërimet e periudhës së regjimit diktatorial të E.Hoxhës, mohimet dhe politizimet e bëra nga historiografë të atij regjimi, por edhe me qëllim të caktuar nga individë që kërkonin lavdi dhe pushtet të pamërituar. Në kurthin e tyre ranë me dëshirë dhe me servilizëm historianë të ndryshëm që e shtrembëruan historinë për karriket e tyre.

Pas viteve 90 dhe ndryshimeve demokratike që ndodhën në Shqipëri, një kontribut dha edhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL). Është i njohur kontributi i saj gjatë procesit të ndryshimeve demokratike e deri më sot.

Dhe pikërisht libri që u botua para katër vitesh në 20 vjetorin e OBVL pasqyron gjërësisht, ndonjëherë edhe në detaje, pa pretenduar se ka thënë gjithçka, punën e madhe të mbi 15 mijë veteranëve që milituan dhe militojnë aktualisht në të mirë të demokracisë shqiptare dhe të së ardhmes së brezave duke pasqyruar sa më drejt këtë luftë legjendare që erënditi Shqipërinë në krahun e fitimtarëve të Luftës së II Botërore. Komiteti Kombëtar i Veteranëve të LANÇ, që ishte drejtuar nga Shefqet Peçi deri në vitin 1991 ka qenë levë e PPSH, por edhe më pas nën drejtimin e Pirro Dodbibës, Adnan Qatipit e Rustem Peçit vazhdon të mbetet një organizatë e politizuar veçanërisht në shërbim të forcave të të majtës shqiptare dhe të PPSH. Prandaj për të penguar këtë qasje negative, këtë tendencë të dëmshme si për demokracinë ashtu edhe për historinë e popullit shqiptar me nismën e një grupi prej 64 personalitetesh, gjeneralësh dhe luftëtarësh, figura politike të respektuara, por fatkeqësisht të dënuar nga regjimi komunist u formua Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës së Popullit Shqiptar (OBVL).

Në këtë grup bënë pjesë figura politike të respektuara që kishin qenë drejtues të reparteve partizane e ministra, siç ishin: Kiço Ngjela, Manol Konomi, Fadil Paçami, Maqo Çomo, Sadik Bekteshi (gjeneral lejtant-Hero i Popullit), Muhamet Prodani (gjeneral lejtant-Hero i Popullit), gjeneral-majorët: Nexhip Vinçani dhe Ernest Jakova; luftëtarët e shquara, drejtues në luftë e aktiviste të OBVL: Selfixhe Broja(Ciu), Zenepe Golemi (Ashiku), Liri Belishova, Vera Ngjela (Pojani), Mine Doraci e disa të tjera, por



fatkeqësisht të dënuara nga regjimi diktatorial i Enver Hoxhës.

Kuvendi i parë themelues i Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (OBVL) në krye të saj zgjodhi personalitetin e shquar Dr. Ymer Dishnicën.

OBVL i bëri thirrje Komitetit Kombëtar të Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare për bashkim, por me kushin e zgjedhjeve të reja në bazë dhe në qendër të veteranëve, të ndryshimit të statutit dhe programit, të rishikimit të historisë së LANÇ, të dënimit të krimeve të komunizmit. Këto kërkesa u refuzuan nga Komiteti Kombëtar i Veranëve të Luftës Nacional Çlirimtare.

Menjëherë pas zgjedhjes, Kryesia e OBVL ju vu punës për përgatitjen e projektligjeve e që do të vinin në vendin e merituar figurën e respektuar të veteranit të LANÇ dhe propozimin e miratimit të tyre në parlament, duke e vënë kështu veprimtarinë e saj mbi baza ligjore në interes të veteranëve, invalidëve



të luftës dhe familjeve të dëshmorëve. Në këtë mënyrë u ligjërue figura e respektuar e veteranit të LANÇ.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ u shtri rrufeshëm në gjithë Shqipërinë. U krijuan dhe u konsoliduan degët tona në rrethet si vijon:

Në Tiranë me kryetar z.Muhamar Spahiu, Korçë, me kryetar z.Haxhi Runi, Elbasan me kryetar z.Sami Vinçani, Durrës, me kryetar z.Idriz Hoxha, Shkodër me kryetar z.Murrem Bushati, Lushnjë me kryetar z.Iliaz Ahmeti, Krujë me kryetar z.Fadil Veseli; Lezhë me kryetar z.Loro Gjeçi, Tropojë me kryetar z.Hamit Neziri; Fier me kryetar z.Nazif Ago, Mat me kryetar z.Ismail Muharremi, si dhe në të gjitha rrethet e vendit. Vlen të përmendet kontributi i veteranëve Fluturak Vinçani (Korçë), Genc Ballanca (Durrës), Osman Xhindoli (Shijak), Jorgji Terca(Tiranë), Agim Dylgjeri(Elbasan), Xhemal Meçi (Pukë), Ali Demushi(Shkodër) etj.

Që nga krijimi i saj në korrik 1994, OBVL ka mbajtur gjashtë kuvende kombëtare, ku më i fundit, ai i datës 28 Maj 2017 shënoi një rekord anëtrësimesh të reja nga pasardhësit.

Gazeta Veterani, organ i OBVL pasqyroi dhe pasqyron vazhdimisht veprimtarinë e kësaj organizate dhe ka ndihmuar në realizimin e objektivave dhe detyrave të saj.

Përveç përvjetorëve të shokëve të rënë në luftë, të pushkatuarit nga diktatura, të vdekurit në burgje e internime, si dhe të figurave patriotike me kontribute të veçanta në luftat për liri kombetare, përkujtimoreve të shokëve që kanë vdekur gjatë kësaj periudhe, veprimtarive të tjera në bashkëpunim me pushtetin vendor në përjetësim të LANÇ, OBVL u bë promotor në mbrojtje të luftës së UÇK dhe të luftës së Kosovës, të mbrojtjes së të drejtave të shqiptarëve në Kosovë, Preshevë, Maqedoni, Mal të Zi, të komunitetit çam etj.

Në përkujtim të këtyre ngjarjeve e figurave, OBVL në qendër e rrethe ka bashkëpunuar me organet e pushtetit, organizatat e shoqatave që zhvillojnë veprimtari shoqërore e patriotike.

OBVL ishte nismëtare në bashkimin e

## GRUPI NISMËTAR PËR FORMIMIN E OBVL-së

- |             |           |
|-------------|-----------|
| 1.Andon     | Sheti     |
| 2.Ali       | Bulka     |
| 3.Alfred    | Moisiu    |
| 4.Bedri     | Shehu     |
| 5.Dashamir  | Ohri      |
| 6.Debo      | Balili    |
| 7.Edip      | Ohri      |
| 8.Ernest    | Jakova    |
| 9.Elami     | Hado      |
| 10.Guri     | Shyti     |
| 11.Haki     | Jupasi    |
| 12.Hamid    | Keçi      |
| 13.Hysni    | Daja      |
| 14.Irakli   | Bozo      |
| 15.Islam    | Bushi     |
| 16.Janaq    | Budina    |
| 17.Josif    | Zegali    |
| 18.Kiço     | Ngjela    |
| 19.Koço     | Qafzezi   |
| 20.Muhamet  | Prodani   |
| 21.Masar    | Shehu     |
| 22.Menber   | Belegu    |
| 23.Mylit    | Gasholli  |
| 24.Manol    | Konomi    |
| 25.Myltar   | Tare      |
| 26.Nurie    | Bozo      |
| 27.Nexhip   | Vinçani   |
| 28.Ndreçi   | Flasari   |
| 29.Nexhat   | Iljazi    |
| 30.Fetief   | Myltari   |
| 31.Petrit   | Malindi   |
| 32.Rahman   | Parllaku  |
| 33.Skender  | Godo      |
| 34.Sami     | Haderi    |
| 35.Sami     | Vinçani   |
| 36.Sotir    | Budina    |
| 37.Sitki    | Bushati   |
| 38.Koço     | Leshnja   |
| 39.Kolë     | Jakova    |
| 40.Lavdos   | Dulaj     |
| 41.Muhsin   | Krovi     |
| 42.Myzafer  | Mati      |
| 43.Malo     | Hasamataj |
| 44.Muhamet  | Spahiu    |
| 45.Shefqet  | Mezini    |
| 46.Sheraf   | Gjebrea   |
| 47.Taqo     | Adhami    |
| 48.Tahir    | Voshina   |
| 49.Tanush   | Shyti     |
| 50.Vangjel  | Rabi      |
| 51.Selfixhe | Broja     |
| 52.Sazan    | Xhelo     |
| 53.Skender  | Malindi   |
| 54.Seit     | Berisha   |
| 55.Shkëlqim | Zaloshnja |
| 56.Shaban   | Reçi      |
| 57.Shemi    | Sadiku    |
| 58.Vangjel  | Pritanji  |
| 59.Vera     | Pojani    |
| 60.Xhavit   | Qesja     |
| 61.Ymer     | Dishnica  |
| 62.Zenepe   | Ashiku    |
| 63.Zekë     | Voshina   |
| 64.Nexhmi   | Balka     |

64 organizatave e shoqatave joqeveritare që u angazhuan totalisht në mbështetje e ndihmë të luftës çlirimtare (UÇK) në Kosovë. Organizata jonë e ka mbështetur edhe Luftën e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare të shqiptarëve në Maqedoni e Luginën e Preshevës për të fituar liritë nacionale e të drejtat njëzëre. Ne kemi mbështetur e mbështesim komunitetin çam në përpjekjet për të fituar të drejtat e mohuara.

Që në ditët e para të çlirimit të Kosovës kemi vendosur lidhje e bashkëpunim të ngushtë me Shoqatën e Veteranëve të LANÇ të Kosovës; bashkë kemi përkujtuar shumë ngjarje të luftimeve për liri e pavarësi e në veçanti ato të LANÇ. Kemi krijuar dhe kemi lidhje të ngushta mes dy kryesive të shoqatave tona.

Kryetari i OBVL-së, gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit, ruan në kujtesën e tij figurat e paharruara drejtuese të kësaj shoqate si: Ramadan Vraniqi, Xhevdet Pula e Vahide Hoxha, me të cilët ka patur bashkëpunim të frytshëm. Ndërsa tani ai ndjehet i nderuar që bashkëpunon me të respektuarit Zija Mulhaxha, Pajazit Nushi e anëtarë të tjerë të Kryesisë të kësaj shoqate, bashkëpunim që ka rezultuar në veprimtari të përbashkëta si në Shqipëri dhe në Kosovë.

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të LANÇ të popullit shqiptar është anëtare e Federatës Europiane e Botërore të veteranëve. Me pjesëmarrjen dhe aktivitetet e këtyre federatave, jo vetëm në Europë, por edhe në Maljazi, në Johannesburg, Marok etj kemi bërë të njohur kontributin e popullit shqiptar në Luftën e II Botërore dhe të luftimeve për liri të popullit tonë në Kosovë, Maqedoni e deri dhe kontributin që japim sot në mbrojtje të paqes në kuadrin e NATO-s.



## HISTORIA

75 VJETORI – Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, datë që nuk duhet harruar

# NGJARJE KULMORE NË HISTORINË E LANÇ

**Rrahman PARLLAKU\***

• *Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 75 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës*

• *Një vit më vonë në Kongresin e Përmetit, Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqëndroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të kryeministrit, të ministrit të jashtëm etj. Por siç dihet ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgaditura, si dhe komandat e njësive e të reparteve*



në të gjithë vendin. Rritja sasiore dhe cilësore e ushtrisë kërkonte drejtim unik dhe bashkërendim të veprimeve luftarake në shkallë vendi.

## HAP CILËSOR NË DREJTIM TË LUFTIMEVE

Krijimi i Shtabit të Përgjithshëm 75 vjet më parë, më 10 Korrik 1943, me vendim të Këshillit të Përgjithshëm Antifashist Nacionalçlirimtar e zgjidhi problemin e drejtimit të përqëndruar të Ushtrisë. Kjo do të përkujtohet si dita e themelimit të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare. Në përbërjen e Shtabit të Përgjithshëm u emëruan figurat më të afirmuara udhëheqëse të Luftës. Komandant i Shtabit u caktua Spiro Moisiu, që ishte jo vetëm luftëtar i afirmuar, por edhe i paisur me kulturë ushtarake.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm u bë një hap cilësor në drejtim të luftimeve, u bë kalimi nga një ushtri partizane me bazë rajonale në një ushtri mbarëkombëtare me strukturë organizative që t'i përgjigjej jo vetëm stadi të arritur, por edhe perspektivës të kalimit në ushtri të rregullt. Shtabi i Përgjithshëm mori masa të menjëherëshme për organizimin e strukturave ushtarake si të forcave operative, territoriale dhe të administratës ushtarake. Në forcat operative hynin brigadat sulmuese, që ishin të destinuara të vepronin në gjithë hapësirën e teritorit të vendit dhe forcat territoriale që vareshin nga komandat e qarqeve.

Në krahinat e çliruara qarqet kishin krijuar organet administrative ushtarake, komandat e vendit në krahina, spitale, depo furnizimi etj. Ky organizim ushtarak e justifikoi plotësisht veten në realizimin e detyrave luftarake nga njësitet e repartet, ku u kombinua mirë drejtimi nga Shtabi i Përgjithshëm me iniciativën e gjerë në veprimet luftarake nga vetë komandat e njësive e reparteve, komandat e qarqeve dhe të Zonës së Parë Operative që përfshinte qarqet Vlorë dhe Gjirokastrë. Kjo iniciativë ishte më se e domosdoshme, pasi luftimet zhvilloheshin pa front të rregullt, mjete teknike të ndërlydhjes e të drejtimit, mungonin

kryesisht, komunikimi me Shtabin e Përgjithshëm me ndërprerje të gjatë kohe.

## PARTIZANËT PËRBALLUAN VËSHTIRËSI MBINJERËZORE

Shtabi i Përgjithshëm, me gjithë kushtet tepër të vështira në të cilat vepronte dhe mungesën që kishte për ushtarakë të mirëfilltë, përgaditi e dërgoi disa udhëzime normative për rregullimin e jetës në reparte, drejtimin e luftimit, rregullin e disiplinës ushtarake, të kombinimit të disjplinës së ndërgjegjshme në zbatimin e detyrave etj. Është me vend të theksojmë se kjo ishte disiplinë shembullore, e vetëpranuar jo vetëm në marrëdhënjet mes luftëtarëve, por edhe me popullin dhe nuk e thyenin atë qoftë edhe kur duhej dhënë jeta.

Masat organizative dhe ushtarake që mori Shtabi i Përgjithshëm, përgaditja dhe edukimi i forcave partizane me ndjenjën e lartë të përgjegjësisë për çlirimin e vendit nga zaptuesit, i bënë repartet dhe njësitet e Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare të përballojnë vështirësi, do të thoshja mbinjerëzore.

Vetëm ai që ka përballuar vështirësitë e Operacionit Nazist të Dimrit 1943-’44 e di fort mirë këtë, të tjerët vështirë ta kuptojnë. Kjo përgatitje shpirtërore dhe vendosmëri për kalimin e vështirësive bëri që repartet e njësitet e dështuara rëndë ta marrin shumë shpejt veten në pranverën e vitit 1944 e të hidhen në sulm që e befasoni keqas armikun. Këtë e kanë shprehur edhe përfaqësuesit e aleatëve në shkrimet e kujtimet e tyre, shumë prej të cilëve kanë ardhur edhe në Shqipëri.

## NDRYSHIMET ORGANIZATIVE ISHIN TË KARAKTERIT OPERATIVO-STRATEGJIK

Shtimi i shpejtë i reparteve e njësive të Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, sidomos krijimi i brigadave sulmuese, veprimet e tyre luftarake në hapësira të mëdha të teritorit, çlirimi i shumë krahinave të vendit, i mbylli nazistët në qytetet dhe në ruajtjen e disa pikave bregdetare e të rrugëve kryesore. Në këto kushte, Shtabi i

Përgjithshëm mori masa për ndryshime organizative e të drejtimit të njësive që ishin të karakterit operativ-strategjik, ndryshime në zhvillimin e veprimeve luftarake, kalimin nga luftimet pa front të rregullt në kryerjen e luftimeve dhe operacioneve në front të gjerë.

Këto masa të parashikuara nga Shtabi i Përgjithshëm, u aprovuan në Kongresin Antifashist të Përmetit më 24 Maj 1944. Kështu u krijua Komanda e Përgjithshme, u vendosën gradat ushtarake, u krijuan njësitet operative strategjike. Të gjitha këto masa i jepnin Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare karakterin e një ushtrie të rregullt, me perspektivë për kalimin në mësymjen e përgjithshme për çlirimin e plotë të vendit.

Komandant i Përgjithshëm i saj u caktua Enver Hoxha, i cili përqëndroi në duart e tij edhe shumë detyra të tjera si atë të Sekretarit të Parë të Partisë, atë të kryeministrit, të ministrit të jashtëm etj. Por siç dihet ai nuk ka pasur as njohuritë minimale si ushtarak, prandaj detyrën e drejtimit të Ushtrisë deri në çlirimin e vendit e kreu Shtabi i Përgjithshëm, i përforcuar me kuadro të përgaditura, si dhe komandat e njësive e të reparteve.

Nazistët e bashkëpunëtorët e tyre bënë tentativën e fundit në shkallë të madhe me Operacionin e Qershorit ‘44 duke grumbulluar forca të shumta për të goditur, dëmtuar e penguar Ushtrinë Antifashiste Nacionalçlirimtare në zhvillimin e forcimin e mëtejshëm të saj dhe luftën për çlirimin e vendit. Por hovi që kish marrë lufta, shtimi e forcimi i vazhdueshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare, e thyen shpejt këtë përpjekje të dëshpëruar të armikut në shkallë vendi. Mbas kësaj Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare kaloi në mësymjen e përgjithshme, gjë që çoi në çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Ushtria Nacionalçlirimtare shqiptare luajti rol të rëndësishëm në Kosovë dhe në krahina të tjera të ish Jugosllavisë. U zbatuan me vendosmëri detyrat e marra nga Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NÇL për të ndihmuar popullin e Kosovës për çlirimin e tij, duke ndikuar në rritjen e pjesëmarrjes të sa më shumë kosovarëve në këtë luftë të madhe, për të patur të drejtën e vetëvendosjes pas mbarimit të saj. Po ashtu u zbatua detyra për ngritjen e pushtetit, pasi shumicën në kështilla e kishin shqiptarët. Brigadat partizane të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare dhanë një kontribut të veçantë në Kosovë. Në zbatim të detyrave të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare shqiptare, brigadat dhe formacionet tjera partizane të kësaj ushtrie u angazhuan për të penguar dhe dëmtuar forcat gjermane në tërheqje, me qëllim që ato të mos shkonin të organizuara në Frontin Perëndimor kudër Aleatëve. Në këtë aspekt është e njohur lufta e dy divizioneve tona në ish Jugosllavi për të ndihmuar në çlirimin e popujve jugosllavë, divizione këto që vazhduan të pengonin e dëmtonin forcat gjermane që tërhiqeshin për në Frontin e Perëndimit, duke dhënë kontributin tonë në kuadrin e koalicionit botëror antifashist.

\*Kryetar i OBVL, gjeneral-lejtënant (në pension), Hero i Popullit dhe Nderi i Kombit



## NGJARJE DHE DATA

# 75 VJET MË PARË, LUFTA PERMET-KUQAR-QAFA E KIÇOKUT- GRYKA E LANÇ, epoka më e ndritur

*- Sipas kujtimeve të ish-nënkryetarit të OBVL-së Skënder Malindi -*

Viti 1943 është viti i kthesës së madhe i Luftes së Dytë Botërore. Iniciativa e luftës, në të gjitha frontet e saj, kalon në komandat ushtarake të koalicionit anti-fashist botëror. Ushtria italiane kishte pësuar goditje të rënda dhe po gjunjëzohej. Populli shqiptar ishte ngritur në luftë kundër ushtrisë italiane duke i dhënë asaj në Shqipëri goditje të njëpasnjëshme për çlirimin e saj.

Koalicioni nazi-fashist, vazhdimisht po pësonte disfatë sin e drejtim politik, ashtu dhe në atë ushtarak.

Duke analizuar këto situata të cilat vinin duke u rënduar vazhdimisht, komanda e ushtrisë italiane në Shqipëri, filloi të merrte masa paraprake për të përballuar çdo të papritur. Për këtë oho nisi të kryente punime xhenerie fortifikuese në disa drejtime operative. Një nga këto drejtime operative-strategjike ishte dhe Lugina e Përmetit që të çon deri në Qafën e Këlcyrës në drejtim të Beratit dhe nga Këlcyra që të çon në drejtim të Tepelenës dhe më tutje. Për të mbuluar këtë drejtim komanda italiane vendosi të krijojë një rajon të fortifikuar në kodrat e fshatit Kuqar që ndodhet midis Përmetit e Këlcyrës, 5 km larg Këlcyrës. Këto kodra zotërojnë këtë luginë dhe mbrojnë drejtimet operative-strategjike. Deri në Qershor të vitit 1943, d.m.th. para krijimit të Shtabit të Përgjithshëm, çetat partizane kishin luftuar në mënyrë të pavarur dhe brënda krahinave të tyre. Megjithatë ishin zhvilluar shumë beteja, të cilat kishin shkaktuar humbje të mëdha në ushtrinë italiane, mungonte një organizim i përgjithshëm, një komandë e centralizuar që do të mund të bënte veprime të koordinuara në një shkallë të gjërë dhe me forca të shumta.

Në Qershor të vitit 1943, në prapagandë e krijimit të Shtabit të Përgjithshëm udhëheqja e LANÇI mori vendim për të goditur repartet e ushtrisë italiane, që kryenin punime fortifikuese në kodrat e Kuqarit. Me këtë synohej gjithashtu, të goditeshin trupat e tyre dislokuara në Përmet për të çliruar këtë qytet me rëndësi.

Këto veprime luftarake do të rritnin autoritetin e LANÇI brenda dhe jashtë vendit si dhe populli ynë do të krijonte besimin më të madh për luftën tonë të drejtë.

Brenda në Përmet ishte vetëm një batalion ushtarak italian si dhe një kompani karabinjesh. Gjithashtu si në Kuqar ashtu dhe në Tepelenë vazhdonin punimet fortifikuese që kryheshin nga dy batalione të tjera italiane.

Asgjesimi i këtyre forcave do të siguronte një kompaktësi më të madhe të zonave Pogon, Zagori, Dëshnicë, Përmet, Dangëlli e Leskovik. Çlirimi i Përmetit do të kishte një rëndësi të madhe politike sepse do të ishte i pari qytet i çliruar i Shqipërisë. Karakteristika e luftes Përmet-Kuqar-Qafa e Këlcyrës dhe Shkalla e Barmashit, ishte se për herë të parë merrnin pjesë forcat partizane të tre qarqeve nën një komandë unike.



Për kryerjen e këtij operacioni me një hapësirë rreth 150 km katror udhëheqja e LANÇI vendosi të formonte një forcë operative të tre qarqeve Korçë, Berat dhe Gjirokastrë. Nga Qarku i Korçës ishte Nexhip Vinçani e Pëllumb Dëshnica, nga qarku i Beratit Xhelal Staravecka, kurse nga ai i Gjirokastrës Islam Radovicka e Tahir Kadare. Në shtabin operativ ishin dhe dy oficerë anglez, ndërlidhës me komandën ushtarake të Mesdheut. Komandant i operacionit u caktua Nexhip Vinçani, ndërsa Shtabi Operativ u vendos në shtëpinë e patriotit dhe bashkëluftëtarit të Çerciz Topullit, Riza Velçishti. Partizanët pas një marshimi të gjatë e të lodhshëm, sepse vinin nga krahina të ndryshme, u vendosën në varësi të zonave ku do të kryenin veprimet luftarake.

## PLANI LUFTARAK

Për zbatimin e detyrës, komandanti i operacionit Nexhip Vinçani, pasi u orientua me terrenin dhe pasi vlerësoi forcat partizane dhe ato italiane vendosi:

**1-** Goditja kryesore do të jepej kundër trupave italianë në Kuqar. Nga veri-lindja do të sulmonte batalioni "Ali Këlmen-di" me komandant Teki Kolanecin dhe komisar Faik Zaimin. Në krahun e majtë të tij do të sulmonte batalioni "Themistokli Gërmenji" me komandant Ali Vinçanin dhe komisar Spiro Shalësin dhe në krah të tij batalioni "Hakmarrja" me komandant Petrit Dumen dhe komisar Josif Pashkon.

Nga ana e kundërt, në bregun e majtë të lumit Vjosa, do të mbështeste sulmin me zjarr çeta e Rrëzës së Përmetit e komanduar nga Riza Çaçi, për të mos lejuar ushtarët italianë të bënin manovra apo të merrnin ujë në Vjosë.

**2-** Goditja tjetër do të jepej kundër forcave italiane të vendosur në qytetin e Përmetit, me forcat e batalionit "Fuat

Babani", i cili komandohej nga Tefik Cakonji dhe komisar Muzafer Spaho sidhe një kompani e batalionit "Riza Cerova", Skrapar, që komandohej nga Shaqir Kapinova. Detyra e këtyre forcave ishte të asgjesonin trupat italiane të vendosura në kazerma dhe të çirohej qyteti i Përmetit.

**3-** Për sigurimin e operacionit nga goditjet e forcave italiane që mund të vinin nga drejtimi Berat-Përmet, u vendosën në Qafën e Këlcyrës dy kompani të batalionit "Riza Cerova", të komanduara nga Neshat Hysi. Ky batalion u formua më 26 qershor 1943 në Qafën e Martës, me komandant Xhelal Staraveckën dhe komisar Ramis Aranitasin. Këta, mbasi marshuan ditë e natë nga Camëria-Vithkuqi-Selenica-Orgocka-Odriçani dhe Suka, më 30.06.1943 mbërritën në Qafën e Këlcyrës. Për zbatimin e detyrës forcat partizane u vendosën në dy anë të rrugës automobilistike që kalon në Qafën e Këlcyrës, në Bregun e Stanit, në Bregun e Korijës, në atë të Xanës si dhe te Përroi i Burimit.

**4-** Në drejtimin Tepelenë-Përmet, zunë pritë tek gryka e Mezghoranit, Çeta "Musa Fratari" me komandant Feti Bubsin dhe komisar Dashnor Mamaqin sidhe Çeta "Koto Hoxhi" me komandant Pano Xhamballan dhe komisar Vasil Katin. Detyra e tyre ishte për të ndaluar ardhjen e forcave italiane nga Tepelena në ndihmë të forcave në Kuqar dhe Përmet.

**5-** Batalioni territorial i krahines së Çepanit, i komanduar nga Xhemal Malindi dhe komisar Iliaz Sevrani, zuri pritë në grykën e Këlcyrës.

**6-** Në drejtimin Korçë-Përmet, zunë pritë në Qafën Shkalla e Barmashit çetat e Çamërisë dhe Panaritit të komanduara nga Riza Kodheli, Çeta e Potomit e komanduar nga Bajram Krasta sidhe partizanë dhe vullnetarë nga Kolonja.

**7-** Vendvajtimi i komandës së operacionit u vendos në një koder 600 m

në jug-lindje të kodrave të Kuqarit.

**8-** Sulmi do të bëhej në orën 4:00 të dates 1 korrik 1943.

Komanda e operacionit dha një varg udhëzimesh mbi ndërlidhjen, bashkëveprimin, mbi furnizimin e partizanëve me ushqime si sidhe për shërbimin shëndetësor.

Sipas vendimit, natën, duke gdhirë 1 korriku, batalionet dhe çetat që do sulmonin garnizonin e Kuqarit dhe të Përmetit, zunë vendet e caktuara, kurse batalionet dhe çetat e tjera u pozicionuan nëpër prita. Kur partizanët po prisnin sinjalin për të filluar sulmin, ndodhi diçka e pa pritur. Një autokolonë italiane, e përbërë nga 5 kamionë, një autobлиндë dhe një motoçikletë, që po udhëtonte nga Përmeti në drejtim të Këlcyrës, ndeshi në një minë dhe për pasojë motoçikleta u hodh në erë.

Partizanët qenë detyruar të hapnin zjarr në drejtim të kollonës të cilën dhe e asgjësuan. Automjetet u dogjën, kurse shumica e ushtarëve mbetën të vrarë.

Batalioni Italian i Kuqarit, që bënte punime fortifikuese, me të dëgjuar goditjen e autokolonës, i la punimet dhe mori masa mbrojtje. Partizanët atëhere u hodhën në sulm. Pas Kuqarit luftimet u ndezën dhe në Përmet. Luftimet vazhduan gjithë natën dhe ditën e nesërme të 1 korriku. Në Kuqar ku jepej goditja kryesore, partizanët kryen disa mësymje rradhazi, por italianët mbroheshin me këmbëngulje duke u përgjigjur me zjarrin e fuqishëm të armëve të tyre dhe duke mos treguar asnjë shenjë dobësimi. Ata i ndihmonin shumë fortifikatat dhe telat me gjëmba që kishin rreth e qark. Akoma më shumë guxim morën, sidomos, kur në mëngjezin e 2 korriku në qiell u dukën aeroplanët luftarakë italianë që erdhën në ndihmë të tyre. Sapo u afruan, ata nisën menjëherë bombardimin dhe mitralimin mbi pozicionet e partizanëve.

Në Përmet batalioni italian u izolua



## HISTORIA

**KELCYRES-SHKALLA BARMASHIT (1-6 KORRIK 1943)****në historinë e Shqipërisë**

në kazerma i goditur nga çdo anë prej zjarrit të partizanëve. Megjithëse njësi-ti gueril i Përmetit preu tubin që i furnizonte me ujë, italianët mbroheshin me këmbëngulje. Batalioni i tyre kishte shumë murtaja të cilat hidhnin predha pa pushim në pozicionet e partizanëve. Ndërkohë një batalion i Italianëve, i përforcuar me artileri dhe një autobлиндë, nga mesi i ditës së 2 Korrikut filloi lëvizjen nga Dragoti për të dalë në Këlcyrë e Kuçar. Forcat partizane që mbronin grykën i kundërsulmuan ashpër dhe i thyen. Bashkë me çetat "Musa Fratari" dhe "Koti Haxhi", natën u bashkua dhe çeta "Haredin Tremishti" me komandantë Xheladin Beqirin (Karadaku) dhe komisar Asim Zeneli.

Në mbrëmje italianët mundën të shpërthejnë qëndresën e partizanëve dhe të arrijnë në Këlcyrë. Prej andej u hodhën në Kuçar, ku u bashkuan me forcat e tjera të rrethuara, duke u bërë gjithsej dy batalione. Këtu sulmet e partizanëve u bënë të pamundura, prandaj ata mbetën në pozicionet e mëpërparshme.

Në oren 4 e 30 te 2 Korrikut, nisën luftimet në Qafën e Këçokut. Dy batalione Italiane, një bersalierësh dhe një këmishzjish, të ngarkuar në 55 kamionash, që shoqeroheshin dhe nga tre autoblinde, donin të çanin rrugën për të arritur në Kuçar dhe Përmet. Partizanët e batalionit "Riza Cerova" qëllimisht i lanë Italiananët të futeshin në pritën e ngritur dhe pastaj u dhanë goditje të forta. Luftimet e ashpër zgjatën rreth 10 orë. Kur ata e panë se nuk po e çanin dot rrugën, vendosën të tërhiqeshin, por dhe tërheqja nuk qe fortë e lehtë, sepse kthimi i makinave në rrugën e ngushtë pati vështirësi. Kjo u kushtoi atyre mjaft të vrarë dhe shumë dëme materiale.

Përveç kamionëve të shkatëruar dhe një autoblinde të djegur, ata lanë në vënd 5 makina dhe një motoçikletë, të cilët u përdorën nga partizanët. Aty u kap dhe një sasi e madhe municionesh e materiale të tjera të vlefshme. Luftimet tona u mbështetën fuqimisht dhe nga zjarri i mitralozit të rëndë "Bredan" që përdorej nga trimi Ferit Radovika nga Bregu I Golemit. Në këto përleshje me trupat italiane ra në fushën e luftës Tajar Hysi, i cili megjithëse u plagos rëndë, u zu gryka-grykës me 5 italiane. Tek kodra e Bregut u vranë Sabri Kacidhia dhe Taip Çela. Po kështu duke luftuar me guzim u vranë: Xhevahir Temani, Haxhi Mborja, një partizan nga Terrova e Beratit dhe Shaban Polena nga Skrapari. Në Kuçar partizanët mundën të shkulnin italianët nga llogoret e vijës së parë të mbrojtjes, ku gjatë luftimeve u vranë Jonus Çuçi e Kosta Goliku. Batalioni teritorial i krahinës së Çepanit futi në dorë Këlcyrën dhe bllokoj rrugën automobilistike, por më tutje ndaluan nga ballistët e Ali Këlcyrës të cilët dhanë ultimatum se do të fillonin luftë kundër partizanëve nëqoftëse nuk largoheshin nga Gryka e Këlcyrës. Me urdhër të Nexhip Vincanit, batalioni u vendos ne Shtikë.

Në Përmet po në datën 3 Korrik, partizanët ngushtuan shumë rrethimin e



italianëve, të cilëve u kishin mbetur në duar vetëm një pjesë e gazermave. Ata rezistonin dhe mbroheshin duke zhvilluar luftime të ashpra.

Aviacioni italian dyfishoi goditjet në krahësim në ditët e mëpërparshme duke bombarduar dhe mitraluar partizanët, por pa shkaktuar dëme të mëdha. Nga ajri aeroplanët hidhnin ushqime dhe municione për trupat e rrethuara ne Kuçar. Partizanët përpiqeshin të qëllonin italianët që mblidhnin parashutat, por ata, për çudi nuk dukej të shqetësoheshin ndaj goditjeve të tyre.

Atëherë, komandanti i kompanisë së batalionit "Ali Kelmendi", Selami Velçani vjen dhe i shqetësuar i raporton komandantit të operacionit për këtë problem. Xhelal Staravecka pasi e dëgjoi, kthehet nga unë dhe më thotë: "Shko Skënder një vrap dhe shiko si është puna". Me shpejtësi arrij tek pozicionet e partizanëve dhe pasi lëshoj ca të shtëna në arën ku hidheshin parashutat shikoj se plumbat nuk rrahin aty ku shënojnë unë por nxjerrin tym rreth 100 metër më afër. Duke e kuptuar menjëherë se ku "çalonte gomari", gradoj malisherin e gjatë ne shënjestrën 6 dhe shoh që tani plumbat po arrijnë në objekt. Atëherë i kthehen Selami Velçanit dhe i them të udhëzojë partizanët që të rregullojnë shënjestrën. Breshëritë e mëparshme dhe pluhuri që mbuloj parashutat treguan që ky problem "elementar" u zgjidh me sukses. Këtu, do të doja të theksoj, që partizanët, në pjesën dërmuese fshatarë shpesh nuk kishin përvojën e duhur me armët dhe funksionin e tyre. Lufta do të ishte shkolla ku ata shumë shpejtë do të specializoheshin, duke formuar kështu një ushtri, e cila do të ishte e aftë të kryente misionin për të cilën ishte formuar.

Në qafën e Këçokut vazhdonin luftimet ndërmjet partizanëve dhe kolonës italiane të bllokuar në Lajthizë. Për të zhbllokuar kollonën, komanda italiane nisi nga Berati forca të tjera të ngarkuara ne 40 makina. Këto forca u goditën me forcë nga partizanët e Skraparit dhe çeta vullnetare e Terpanit duke u bllokuar aty deri në mbrëmjen e 4 Korrikut.

Të nesërmen në mëngjezin e 5 Korrikut, të dyja kollonat italiane u bashkuan në Lajthizë, ku formuan një forcë

me rreth 2300 mijë ushtarë dhe lëvizën drejt Përmetit. Me ndihmën e artilerisë dhe të aviacionit italian ata mundën të mposhtnin qendrën e partizanëve në Qafën e Këçokut dhe të arrijnë në mbrëmje në Këlcyrë.

Mbrritja e një fuqie kaq të madhe, rrezikonte forcat partizane në Kuçar dhe Përmet prandaj dhe komandanti i operacionit vendosi tërheqjen e tyre, e cila u bë me rregull të plotë.

Italianët, më 6 Korrik u futën në Përmet, i cili ishte i boshatisur nga partizanët dhe banorët e tij. Ata dogjën të gjitha dyqanet dhe shtëpitë e qytetit. Në total u dogjën 175 dyqane, 125 shtëpi dhe 10 godina të administratës qeveritare. Dogjën gjithashtu dhe Këlcyrën, por këtu u zgjodhën vetëm godinat që ishin pronë e partizanëve, si hoteli i Xhemal Malindit, ai i Abaz Sevranit dhe disa të tjerë duke përjashtuar ato që ishin prona të Ali Bej Këlcyrës. Nënprefekti i Përmetit i cili shkoi në Gjirokastrë, tregonte se si ushtria Italiane si rapreziale, dogji gjithë qytetin e Përmetit, të cilin gjatë luftimeve dhe e kishte bombarduar me aviacion. "Lajmet njoftojnë edhe djegien e Këlcyrës dhe të shumë katundeve. Ushtria është duke djegur arat me grurë dhe katundet rreth Përmetit. Popullsia ka marrë shpellat e qytetit dhe është pa bukë e strehë..."

Komanda e 9 – të e armatës së trupave Italianë pohonte: "Ditën e 1 Korrikut në teritorin e divizionit "Parma" u dhanë njëkohësisht katër goditje nga kryengritësit me një këmbëngulje dhe shtjellim forcash deri më sot të pa parë. Veprimet luftarake gjatë boshtit Berat – Këlcyrë – Përmet dëshmojnë për një ide të gjërë, për një përgatitje të kujdesshme dhe këmbëngulëse, si dhe për një bashkërendim të qartë të aksionit. Në mëngjesin e 6 Korrikut, një divizion gjerman me automjete lëvizi nga Follorina në drejtim të tokës shqiptare. Ai hyri ne Korçë dhe duke vazhduar rrugën për Janinë, në Shkallën e Barmashit u ndesh papritur me një zjarr të dendur. Ishte ora 15 e 30 e dates 6 Korrik. Nga zjarri i partizanëve u shkatërrua një motoçikletë që ra në minë dhe disa makina ku u vranë disa ushtarë nazistë. Gjermanët tentuan me çdo kusht për të vazhduar lëvizjen përpara por nuk mundën. Një autobлиндë doli në krye të kollonës por ndeshi në një minë tjetër

dhe u shkatërrua. Luftimet vazhduan 7 orë deri në mbrëmje vonë. Për humbjet e pësura gjermanët, më 6 korrik në Borovë, pushkatuan 107 vetë dhe dogjën gjithë fshatin.

Përsa i përket raporteve të Ballit Kombëtar me partizanët, goditja e parë ndërmjet këtyre dy forcave ndodhi në fshatin Kurtës të Kolonjës.

Partizanët e batalionit "Fuat Babani" gjatë rrugës nga Përmeti për në Devoll kaluan përmes këtij fshati. Ballistët vendalinj, sapo i panë reagues mjeherë dhe i goditën. Kaq u desh dhe lufta u ndez e egër ku si përfundim dy partizanë mbetën të vrarë, kurse nga krahu tjetër "ktheu patkonjt" komandanti i "Balli"-t, Xhelal Kurteshi.

Ky "takim" i parë me gjakderdhje, që do të pasojë dhe me shumë të tjerë ishte një aspekt shumë i dhimbshëm që shpesh i ngjante luftës civile. Se cilat ishin motivet e kësaj përçarjeje politike, ideologjike, lufta për pushtet apo dora e huaj, përgjigjen e vërtetë ndoshta nuk do ta mësojmë kurrë. E saktë është vetëm, se ky ishte një kurban krejt i panevojshëm, sepse dhe pa të, të shumë ishin ata që kishim bërë dhe do të bënim.

Në përfundim mund të dalim në këto konkluzione:

1.Lufta Përmet-Kuçar-Qafa e Këçokut-Grykë e Mezhgoranit-Shkalla e Barmashit, u karakterizua nga pjesëmarrja në të e një sasi të konsiderueshme të forcave partizane të të tre qarqeve, e cila u zhvillua në një hapësirë prej 150 km katrorë dhe drejtuar nga një komandë e vetme. Një operacion i tillë, unik, nuk u përsërit më gjatë gjithë luftës partizane.

2.E meta e këtij operacioni ka qenë mungesa e një organizimi optimal dhe sigurimi i epërsisë së nevojshme të forcave në Kuçar, aty ku jepej dhe goditja kryesore. Gjithashtu nuk u morën masat paraprake efektive dhe organizative për të siguruar më mirë pritën tek Gryka e Këlcyrës, prej nga italianët shpërthyen pa vështirësi të mëdha në drejtim të Këlcyrës, duke u ardhur në ndihmë trupave të tyre në Kuçar, kur ato ndodheshin në gjendje kritike.

3.Pavarësisht se nuk u arrit plotësisht objektivi i caktuar për asgjësimin e trupave italiane në këtë rajon të fortifikuar, sidhe dëbimi i tyre nga gjithë rrethi i Përmetit, kjo luftë përbën një epope të lavdishme për popullin kryengritës shqiptar dhe një grusht të rëndë për ushtrinë pushtuese. Kjo luftë u shkaktoi atyre shumë të vrarë e të plagosur dhe akoma më shumë, uli krenarinë dhe moralin politik të ushtarëve italianë.

4.Kjo luftë vërtetoi se ishte i nevojshëm krijimi i një organi qëndror si Shtab i Përgjithshëm, që të kordinonte e drejtonte veprimet luftarake të të gjitha forcave partizane në Shqipëri.

5.Gjithashtu kjo luftë tregoi nevojën për të krijuar njësi të mëdha partizane si brigada e divizione, të afta për të kryer veprime luftarake me rëndësi taktiko-operative.



## FORUM

*Mjeshtri i lirikave dhe vargjeve për dashurinë, Lasgush Poradeci, ka lënë në veprën e tij edhe një baladë epike pak të njohur.*

# E vërteta e betejës së Pojskës në vargjet e Poradecit

**Nga Myfit GUXHOLLI**

Më shumë se një poemth, shkruar me vlagën e kohës, “Balada për Reshit Çollakun” është një kronikë e plotë e realizuar me mjetet e poezisë për epopenë e heroizmit dhe sakrificave që demonstuan djemtë e Mokrës dhe Pogradecit në betejën e Pojskës, më 16 korrik 1943. I pandikuar ideologjikisht, Lasgush Poradeci, përtej lëvdatave për komisarë e bolshevikë, himnizon me mjeshtëri qëndresën shembullore të antifashistëve të zonës së tij.

“Një tym një mjegull duket/Ca krisma ndihen larg/Një tufë trimash sulen/Me shpirt e zemër flak...”. Në sfondin e zjarrtë të epopesë legjendare të Pojskës martire, gjeniu i lirikave, risjell çast pas çasti dinamikën e betejës dhe nga fillimi në fund mban në qendër të baladës protagonistët e saj, ata që do të martirizoheshin në krye të frontit. Balada e Poradecit, nuk mban kështu vetëm palcën e ngjarjes, po tërë sfondin dhe kronikën e saj...

## POJSKA E 16 KORRIKUT '43

Epopeja e Pojskës mban datën 16 korrik '43. Ajo ka në qendër të saj protagonistin kryesor, Reshit Çollakun. Gjithçka erdhi natyrshëm, si pjesë e zhvillimeve luftarake të djemve e vajzave antifashiste të Pogradecit. Si pjesë e nevojës për të zhdukur pushtuesin



italian nga trojet shqiptare. Vetë beteja e njohur me emrin e zonës së Pojskës u zhvillua nga partizanët e batalionit të Mokrës që komandohej nga Reshit Çollaku, në bashkëpunim me forcat e rrethit të Elbasanit. Vendimi për të sulmuar në Pojskë u përcaktua nga shtabi operativ, para një konsulte paraprake ku u diskutua për ta dhënë goditjen aty apo në anën tjetër të Qafë Thanës. Pasi u përzgjedh goditja në zonën e Pojskës, Reshit Çollaku mbledhi batalionin dhe detajoi detyrat. Sipas planit të tij, partizanët u ndanë në katër grupe. Në krahun e djathtë (nga ana e Pogradecit) do të op-

eronte grupi i komanduar nga Nexhat Hyseni dhe Hetem Haxhiu. Në të majtë partizanët e drejtuar nga Muharrem Çollaku dhe Xhevit Hyseni. Në qendër vetë kreu i batalionit, Reshit Çollaku, që do sulmonte me mitralozin e rëndë. Ndërkaq një grup tjetër i drejtuar nga Abaz Ago do qëndronte i tërhequr për t'i paraprirë goditjeve nga shpina. Me marrjen e urdhrit, forcat nisën lëvizjen nga vargmali në drejtim të fushës. Pavarësisht rezervave që kishte shfaqur për sulmin në fushën e Pojskës, Reshit Çollaku u vu në ball të betejës duke zgjedhur pozicionin më të rrezikshëm për vete...

## I PARI RA KOMANDANTI

Vetëm pak çaste pasi forcat ishin pozicionuar në të dy krahët e rrugës automobilistike, u duk motoçikleta e parë me një civil. Pas saj, 2-3 makina me ushtarë italianë. Pa mbërritur mirë në mesin e fushës, Reshit Çollaku i gozhdoi në vend me sulmin e befasishëm me mitraloz. Thirrjeve të tij “Arrendetini”, (dorëzohuni) italianët do t'i përgjigjeshin me një kundërsulm të rrufeshëm. Reagimin e tyre do ta bënte edhe më agresiv ardhja e një autoblinde me ushtarë të tjerë. Prapa saj një autobлинд tjetër dhe një veturë. Njëherazi me sulmin e Reshitit kishin filluar të godisnin nga të gjitha krahët edhe partizanët e tjerë. Përpjekja sa vinte e

bëhej më e ashpër. Komanda italiane mbasi studioi situatën dhe raportin e forcave, i kërkoi shtabit epror për t'i çuar në ndihmë forca të tjera. Sakaq nga Korça, Pogradeci, Struga e Elbasani filluan të vinin përforcime. Po kështu nga liqeni hapte zjarr një moto-vedetë me topa dhe mitraloz. Nga ajri vepronte një aeroplan, i cili mitralonte pa pushim pozicionet e partizanëve. I gjithë ky rrebes i kundërshtarëve filimisht krijoi situatë kërcënuese për grupin e partizanëve që vepronte në qendër. I pari ra komandanti Reshit Çollaku. Pas tij e mori komandën Siri Kodra n/komandant i batalionit të Dumresë. Po dhe ai do të binte pas pak çastesh për ta vazhduar drejtimin Spiro Gjoknuri. Plumbi do të përshkruante ndërkaq edhe trupin e tij. Një tjetër kuadër do të merrte komandën e batalionit të gjendur në darën e rrethimit. Po edhe Ptoleme Xhuvani, ish-anëtar i komitetit të qarkorit të Elbasanit do të binte në ballë të betejës. Dhjetë martirë do t'i kushtonte beteja batalionit partizan në Pojskë deri në momentin e tërheqjes së rrezikshme. Një humbje shumë e madhe që do të ishte katastrofike pa realizuar tërheqjen. Forcat italiane pësuan një humbje jo të vogël, me 25 ushtarë të vrarë dhe shumë armatim të kapur. Pojska do të ishte ndërkaq varri i gjeneralit italian dhe tre ushtarakëve të lartë, që kishin ardhur për përforcime.

## USHTARAKET DHE TRANZICIONI NE “ZHBERJE E BERJE TE SHTETIT”

**Dhimiter Ndrenika**

Sistemi shoqëror “komunizem” deshtoi. Asnje shoqëri deri me sot, synimin themelor, “puno sa ke mundesi dhe merr sa ke nevojë” nuk e arriti. Ky qellim “fisnik”, dhe kjo “enderr”, mbeti utopi. Shoqëritë e sotme, përfshirë ne shtete, kane ndjekur rrugë të ndryshme: ate “totalitariste” dhe ate “demokratike”. Edhe RSH, si shtet i vone, perqafoi zhvillimet e periudhave historike të etnise shqiptare. Ky rrugetim i gjatë historik përfshiu “etnine e lire” ose primitive, ate “te copezuar skllave dhe feudale” dhe ne periudhen dyshekullore të fundit, ate “te perziere feudoborgjeze, kapitaliste” si dhe “komuniste” e “post komuniste”. Te gjitha keto shoqëri-shtete gradualisht zevendesuan njera-tjetren. Pavaresisht kesaj, etnia shqiptare u perball e perball me te qenit “e copezuar ne Rajon” dhe emigrim “jashte trojeve te saj etnike”, me origjine “pellazgjike”.

Shqiptaret luftuan e luftojne per drejtesi shoqërore. Po ashtu edhe per “endrren komuniste”, qe deshtoi, por qe ne realitetin e sotem botëror e shqiptar, mund te shprehet ne “mireqenije per kontributin e tyre e bashkejetesen paqesore, pa shfrytezim e perdorim, te lire e barazi dhe kunder cdo lloj dhune e perjashtim nga qeverisja”.

Shoqëria e vendosur me dhune, arme e lufte e perqafuar nga “komunistet” deshtoi. E majta botërore u nda ne: shtete sociale “me baze dhunen e armet e luften” nga “ata qe e perjasht-



tuan kete dhune, arme e lufte”. E majta shqiptare, “partia-shtet” u detyrua “te pranoje ndryshimin”, “te rrezojte diktaturen” dhe njeheresh ne strategjine e saj i mbeti “besnike” “praktikave te dhunes” per rimarrjen e pushtetit, qe ajo te “sun-

doje ne RSH”, deshmi e te ciles eshte “te qenit larg te RSH si shtet demokratik”, provuar me ngjarjet e viteve 1997-1998 e ato pragu lufte sociale te viteve pasuese e deri me sot, qe shteti e shoqëria sundohet nga “padrejtësia shoqërore” dhe

“oligarket e çdo ngjyre partiake”.

Zhvillimet postkomuniste në RSH dëshmojnë e, në vijimësi, vërtetojnë, se “tranzicioni i brishtë demokratik i vendit nga sistemi njëpartiak i partisë-shtet” ka dështuar e se hap pas hapi në vend të këtij “shndërrimi” po vjen e zëvendësohet me një sistem “demokracie”, tashmë konfiguruar si “zhbërje” e “bërje Shteti “jo më nga themelet e shtetit të së drejtës, por në një “shtet oligark”, “i shtetit publik-privat” e i zëvendësimit të demokracisë në një sistem “diktatorial të ri”, përfaqësuar nga një shumicë njëpartiake kuvendore, ardhur në pushtet në bazë të një sistemi zgjedhor “manipulativ e të shitblerjes së votave e të deputetëve”, rrjedhojë e përjashtimit total të partive të vogla, lëvizjeve politike e shoqërore, grupeve e shoqatave e kandidatimit të pavarur, si dhe abuzimit total me pushtetin që gëzojnë, dhe ai vetë, përfituar me manipulim.

Nuk përfaqëson “demokracinë”, as “parlamentarizmin” “shitblerja e deputeteve” përfaqësues të interesave jetike të atdheut, kombit e popullit. Kete deshmon ky tranzicion i deshtuar demokratik. Fitorja e se majtes ne vitin 1991 ishte e deshtuar, ndersa fitorja e se djathtes ne vitin 1992, e besueshme si “mohim” i “partise-shtet”. Ky tranzicion demokratik duhet “te çrrenjoste” partine-shtet dhe ta shndërronte RSH ne nje shtet demokratik ne baze vlerash euroatlantike. Kjo deshtoi. Ligjet zgjedhore pranuan “vjedhjen e votes”, si ai “mazhoritar” ashtu edhe ai “proporcioal

**(Vijon ne faqen 7)**



PROMOVIMI

*Dr.Arsim Spahiu boton librin “Mbi mitologjinë dhe fenë e maqedonasve të vjetër*

Një vlerë e shtuar për historiografinë shqiptare

Prof.ass.dr.Shefqet HOXHA

Është e dymbëdhjeta herë që dr. Arsim Spahiu na tubon për të promovuar opusin e tij historik. Unë i kam ndjekur me kërshtëri këto aktivitete, ashtu si shumë prej jush, më kanë ngazllyer, më kanë emocionuar dhe më kanë bindur se veprat e këtij historiani të lashtësisë janë një vlerë e shtuar për historiografinë shqiptare edhe pse ndonjëherë nuk janë pritur mirë në rrethet shkencore tonat.

Dr. Arsim Spahiu është një historian “rebel”, jokonformist, që zbulimet e tij në historinë e popujve të lashtë të Ballkanit (pellazgë, ilirë, maqedonas të vjetër, epirotë) i pohon pa droje, çiltas dhe pa u shqetësuar se dikuj mund t’i kruhet qerosa. Dhe mirë bën, sepse “e vërteta mbi të gjitha” dhe kjo nuk është monopol i askujt, pa dyshim as i Arsim Spahiut.

Mijëra faqe na ka shpaluar opusi historik prej 12 vëllimesh i z. Spahiut, disa mijëra zërash bibliografikë na janë ofruar dhe shumica prej tyre nuk gjenden në skedarët e bibliotekave tona. Është një punë tejet e madhe, tejet e mundimshme, mbinjerëzore do të thoja, por edhe e kushtueshme, që për fat të keq po vuan heshtinë e kobshme të institucioneve tona shkencore, ndonjëherë mëninë e tyre. Kritika historike është e shukët, por kjo jo vetëm për veprat e Spahiut. Megjithatë, kjo gjë nuk e ka penguar këtë të punojë, të gërmojë e të na servirë nga Parisi të dhëna të panjohura dhe teza të reja për historinë e të parëve të shqiptarëve. Vepra e tij përkohet tejndanë nga atdhetaria, sepse Arsim Spahiu vjen nga ai tedel.



Vazhdo, Arsim, sepse, për mua, je në rrugë të mbarë!

Vepra që po promovohet sot “Mbi mitologjinë dhe fenë e maqedonasve të vjetër” e shtrirë në 228 faqe përbëhet prej tre pjesësh: “Mbi mitologjinë e maqedonasve të vjetër”, “Mbi fenë e maqedonasve të vjetër” dhe “Pellazgët dhe feja pellazgjike”. Lënda është shoqëruar me 350 shënime dhe pajisur me 129 zëra bibliografikë. Në trajtimin e lëndës janë ndjekur rrugë të huajtura nga historiografitë franceze e amerikane. Si risi të këtij studimi na vijnë citimet nga shumë autorë të njohur e të panjohur të antikitetit grek. Edhe në këtë vepër Arsimi e ka nxjerrë shpatën nga milli e ka hyrë në dyluftim me historianë të njohur. E ka futur umin thellë e më thellë

në historinë e Ballkanit të lashtë, duke u ngatë, madje, deri te pellazgët, për të cilët historiografia shqiptare, me sa e di unë, ende po heshhtë.

Dr. Spahiu në këtë vepër si dhe në vepra të mëparshme bën dallim të prerë midis grekëve e maqedonasve të vjetër, midis këtyre e pellazgëve dhe këto dallime – sipas tij – vërehen edhe në mite e legjenda, në fe – po se po.

Në përfundim të këtij studimi dr. Spahiu nënvizon këto teza:

- 1.- Maqedonasit perëndimorë dhe epirotët e lashtë janë pellazgë ose ilirë;
- 2.- Pellazgët nuk kanë huazuar asgjë nga mitologjia dhe feja greke;
- 3.- Grekët kanë huazuar mitet dhe fenë e pellazgëve;
- 4.- Përpjekjet e grekëve për të ndryshuar mitologjinë e pellazgëve nuk kanë pasur sukses, ndërsa mitologjike pellazgjike ka ndikuar te grekët, të cilët kanë marrë nga pellazgët elemente të rëndësishme të kulturës së tyre.

Po ashtu – vëren autori – ka edhe dallime midis feve të pellazgëve e grekëve.

Dr. Spahiu ka shkruar për pellazgët e ilirët në veprat e mëparshme, për iliricitetin e maqedonasve të vjetër dhe epirotëve, për dallimet e qarta midis grekëve e maqedonasve të vjetër në pikëpamje etnike, kulturore e gjuhësore, vepra e tanishme rreket t’i vijnë në ndihmë autorit për t’i përforcuar këto dallime, prandaj duhej të botohej më parë, megjithëse dihet se mitet nuk janë histori, por u interesojnë dhe u ndihmojnë historianëve.

Mitologët tanë dhe fjalorët mitologjikë të botuar tek ne nuk kanë arritur deri te shumë teza që shpalon monografinë e tanishme e dr. Spahiut, por

nuk është kurrë vonë për ata që nuk i konsiderojnë kërkimet e tyre të mbaruara.

Ka ardhur koha, ndërkaq, t’u qasemi tezave të njohura të Kreçmerit mbi pellazgët dhe pellazgishten. T’u qasësh nuk do të thotë t’i pranosh a priori, por të pralmenish arritjet e derisotme mbi shtëgtimet e popujve nga veriu në jug.

Dy fjalë edhe për autorin e librit, ish nxënës imi në gjimnazin e Kukësit, në vitet 50 të qindrvjetit të kaluar, s’po më rrihet pa i thënë.

Pinjoll i një familjeje atdhetare Spahijash të Kolesjanit, me dhunti natyrore, por me një odise të dhimbshme jetësore, përzënë dhunshëm nga Kosova prej shovinistëve të Beogradit, ndërsa sllavo-komunistët e Tiranës i ndërpresin studimet universitare dhe pa re në qiell e degdisin për 29 vjet në baltat e Myzeqesë.

Në vitin 1991 braktis atdheun dhe vendoset në Francë, ku me vështirësi integrohet në jetën dhe kulturën e atjeshme. Me ndihmën e organizmave të të drejtave të njeriut, pse i moshuar, lejohet të ulet në bankat e shkollës për të përfunduar tri ciklet e arsimit francez; ku përthithi ajkën e historiografisë për Ballkanin në bibliotekat e Parisit.

Doktoron në historinë e lashtë e shkruan vit pas viti 14 vepra (dy prej të cilave letrare), të cilat i ka promovuar këtu në Tiranë dhe sot ky burrë i nderuar ndodhet para nesh. Siç duket, tedeli dhe Zoti i dhanë forcën e duhur për t’u treguar kush është.

*Qofsh faqebardhë, o lumjan i mirë!*

USHTARAKET DHE TRANZICIONI NE “ZHBERJE E BERJE TE SHTETIT”

(Vijon nga faqja 6)

rajonal” , kur Dushku i dha se majtes 12 deputete, ndersa ai proporcional rajonal u dha fitoren “koalicioneve parazgjedhore” ne dem te partive te vogla, pothuaj se 20% e me shume e votave u perfitua nga partite medha-socialiste e demokratike - e njeheresh u lejua “krijimi i grupeve parlamentare” me “deputete te partive te medha e te tjere” fiktive, qe prishen ekuilibrin ne Kuvend deri ne shkeputje sektare nga vete partite e medha apo dhe “delegimi” i deputeteve te tyre per partite e vogla qe nuk mund te krijonin grup parlamentar, pasoje e “aleancave postzgjedhore”. Krahass, blerjes faktike te deputeteve te ndersjellta nga partite, si e majta edhe e djathhta shqiptare arriten te “qeverisin RSH” vetem me “bashkim me te majten” nga PD me 2009 dhe “bashkim me llojin e vet bindjeje politike” nga PS me 2013 nepermjet LSI. Vete keto qeverisje ishin larg “premtimeve te tyre”. Kjo dukuri, njohur tashme, ende nuk po merr rrugezgjidhje sepse ne te dy llojet e sistemeve-mazhoritar e proporcional rajonal apo te paster, kombetar-partite politike kerkojne te ruajne epersine e sundimin absolut ne RSH me keto vete sisteme tashme te provuara si “prodhuese te vjedhjes se votes”. Faktor kryesor ne

kete dukuri eshte krijimi i oligarkive partiako-kriminale, te cilat e mbizoterojne sot jeten e vendit. Kjo vjedhje “vote” eshte shtrire edhe ne perpjekjet per te perfshire emigracionin shqiptar ne votime, nderkohe qe te emigruarit nuk mund te zgjedhin per partine qe votojne sepse mbi ta vepron e dikton mireqenijen e tyre shteti ku kane emigruar dhe jo qeverisja ne RSH.

Keto dukuri,per nga e drejta themelore e njeriut, nuk iu perngjasin as “pleqesive te bashkesive te lira shqiptare” te se kaluares, qe permbanin me shume vlere demokratike se sa ato te “parlamentarizmit te sotem” shqiptar.

Keto deshmojne per nje “kthim te madh pas”,e bajraktarizem vetiak e oligark,diktatorial”, per sundim te pandare me te tjeret ne RSH. Shteti e shoqeria sundohet sot nga nje parti e vetme, ajo socialiste, qe nuk deshmon perfqesim te shtresave me mendesi socialiste e qe nuk shpreh bashkejetese paqesore por nxit, sic deshmohet edhe me shume me fitoren e socialisteve ne 2017, me arrogance e diktatin apsolut te kreut te saj.

Shtetas shqiptare, edhe ushtaraket, u perfshine ne kete “tranzicion demokratik”, por si deshmohet nga praktika, edhe ata “u bene pjese e militanizmit partiak” nepermjet perfshirjes ne levizje e parti politike, qe

perben dhe menjanim, shmangje nga “misioni themelor kushtetues i tyre”, i tere koherave qe shteti ka patur ushtri e organe te sigurise,” mbrojtje, siguri e garante te vendit” e RSH.

“Zhbërja e bërja shtet” nga përmbysj e sistemit të centralizuar të ekonomisë u bë nën “konceptin-ZERO-nga e para e tërë pasurisë shtetërore si në v.1991 ashtu dhe në v.2013”, duke asgjesuar ato marrëdhënie të ndërtuara me fillimin e krijimit të shtetit më të hershëm shqiptar, kur “u shkatërruan nga themeli” të gjitha pasuritë ekonomike, të institucioneve etj. strukturave ekonomiko-financiare e të vetë “pasurisë kombëtare”, që solli thjesht “humbje kohe” e varfërim total e absolut të nivelit të jetesës, duke e kthyer Republikën e porsalindur në nivele të papranueshme nga shtetasit me një mirëqënie tepër të ulët, nën nivelet e fqinjëve dhe jo me sloganin-premtim “të bëjmë Shqipërinë si EUROPA”, që dështoi se qe vetëm mashtrim.

“Zhbërja e shtetit” shënon lindjen e një të “riu”. Ai shkatërron marrëdhëniet e vjetra ekonomiko-shoqërore dhe i rindërton ato,me synim “të përfitimit të lirisë, pronës e rritjes së mirëqënies”. Për nga “pranimi” shteti ka qenë: bashkësi primitive, skllavo-pronar, feudal e më pas kapitalist dhe socialist”. Për nga natyra ideologjike, shtetet “so-

ciale” u emërtuan “demokratike”, “komuniste”, “fashiste”, “naziste”, “fetare” me përbërje një a shumëkombësh a me “pakica” etnike apo kombësish. Këto shtete, historikisht, dështuan me ndarjen e shtetit nga “feja” si dhe nga “krijimi i shteteve nacionale-njëkombësh me ose pa pakica etnike” që përfundoi në Europë aty nga fundi i shek 18-të, kurse shtetet “komuniste” të “modelit sovjetik”, siç qenë “Republika e sovjetëve” në Gjermani dhe ajo në Hungari në vitet 1919 dështuan pas mosrealizimit e mospranimit nga këto shtete të doktrinës “model sovjetik” pas Luftës së I-rë Botërore, që vijoi me “forcimin e modelit sovjetik në lindjen europjane”; me mbarimin e Luftës së II-të Botërore, u shkatërruan edhe “shteti fashist Italian” dhe ai “nazist gjerman” e me rënien e “shtetit komunist në ish-BS” ku u predikuan si “shtete sociale” dështoi përfundimisht “eksperimentimi shoqëror komunist” sepse në këto shtete u imponua centralizimi ekonomik e shoqëror me shtetëzimin e pronës private dhe asgjesimin e lirie e të drejtave të njeriut me sundimin absolut të një klase shoqërore përfaqësuar nga partia komuniste ose emërtim tjetër” me“sundim diktatorial që shtetëzoi ekonominë dhe vuri në themel të tij padrejtësi totale sociale”.

*(vijon nr. e ardhshëm)*



## IN MEMORIAM

# Luftëtari Mato Mato, akoma nuk ka marrë statusin e “Dëshmorit të Atdheut”

**Nga Prof. Asoc. Dr.  
Bernard ZOTAJ**

Familja ku u lind Matua ishte një familje me tradita të shquara luftarake, atdhetare, patriotike e lirisdashëse. Të parët e tij kishin luftuar historikisht me osmanët, andartët grekë e më tej edhe me pushtuesit italianë e gjermanë. Aktiviteti i Matos nis që në moshë të re me aktivizimin në njësitet guerile të fshatit dhe të krahinës. Frymë e luftës për liri kishte shkuar gjer në fshatrat e thellë të Labërisë dhe ishte dhënë kushttrimi për luftë dhe burrë për shtëpi. Fushëbardha një nga fshatrat e dëgjuar të Labërisë mbushi vrullshëm rreshtat e çetave, batalioneve e brigadave partizane. Ky fshat në mes të maleve të Labërisë i dha atdheut 15 dëshmorë në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Gjatë LANÇ-it në vitet 1939-1944, morën plagë dhe ngelen invalidë dhe mjaft luftëtarë të tjerë ku midis tyre ishte dhe Mato Mato.

Matua në një moshë të pjekur u aktivizua në interes të Lëvizjes Nacionalçlirimtare në fshat e krahinë, ku shtëpinë e tij e ktheu në një bazë të rëndësishme për luftëtarët e lirisë. Ai mori vendim dhe doli partizan, vendim të cilin e përkrahu dhe familja dhe veçanërisht babait të tij. Kështu në vitet e para të luftës duke u nisur nga pjesëmarrja në njësitet guerile të krahinës së Kardhiqit, më 12 dhjetori të vitit 1942, u rreshtua luftëtarë i çetës së parë partizane të Fushëbardhës, çetë që mori emrin e luftëtarit të shquar të lirisë Çerçiz Topulli. Çeta nisi veprimtarinë luftarake me aksionin që në ditët e para në Rrëzomë, në Krahinën e Kardhiqit, për të vazhduar më tej deri në Konispol. Me partizanët dhe kuadrot me përvojë në luftime dhe eksperiencë përfitoi dhe luftëtari Mato Mato, i cili u shqua që në fillim të luftimeve si një ndër partizanët më trima e më të dalluar të çetës.

Luftëtari Mato Mato më 13 prill 1943 në Cepo, pranë Plesatit, u rreshtua në batalionin territorial të Fushëbardhës së bashku me 72 luftëtarë. Ky batalion komandohej nga komandanti i sprovuar në betejë Karafil Bello dhe zëvendëskomandant Nexhip (Xhipe) Kozaku. Pjesë e luftëtarëve të batalionit ishin shumë trima të tjerë si Sami Golemi, Mato Serjan Mato, Nishat Çarçani, Hodo Basho, Tafil Lagji, Dino Meçani, Destan Nora, Ferik Shalari, Maliq Cama, Shefqet Golemi, Hodo Basho etj. Mato Mato ishte një luftëtarë i denjë i batalionit partizan territorial të krahinës së Kardhiqit. Ky batalion më 7 gusht 1943 do të krijonte batalionin partizan “Asim Zeneli” te rrepet e Kardhiqit, si njësi e madhe partizane të krijuar me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH.



## MITRALIERI NË BRIGADËN PARTIZANE

Në batalionin partizan “Asim Zeneli” partizani Mato mësoi mitralozin në një kohë të shpejtë dhe u bë mjeshtër në përdorimin praktik dhe teknik të tij, si dhe dha rezultate të larta në qitjet luftarake që bënte batalioni para së të futej në luftime. Kështu mitralieri Mato Mato tregoi trimëri të rrallë dhe u plagos dy herë, por nuk u tërhoq nga fronti i luftës.

Plagët do të shëroheshin bashkë me Shqipërinë e lirë, ju thoshte shokëve të luftës. LANÇ-i mori hov të madh veçanërisht në Pranverë të vitit 1944. Matua ishte bërë një luftëtar profesionist në radhët e rreshtave partizane. Në maj të vitit 1944, vetëm katër ditë përpara se të fillonte punimet Kongresi i Përmetit, më 20 maj 1944, rreth 600 partizanë e partizane të ardhur nga Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë-Mallakastër, u mblodhën në Sukë të Përmetit dhe krijuan Br. XII S, ku komandant u caktuar Refat Bajramin dhe komisar Qemal Klosin.

Detyra e parë e luftarake e Br. XII S ju caktua mbrojtja e qytetit të Përmetit, ku zhvillonte punimet Kongresit Antifashist. Emri i Br. XII S është i lidhur me Kongresin e Përmetit ndaj dhe është thirrur “Brigada e Kongresit”, kështu e njohu historia. Brigada në organizimin e saj i ndau forcat luftarake në 4 batalione duke ju caktuar detyrë konkrete për mbrojtjen e qytetit nga ndonjë sulm i papritur i armikut. Në këtë brigadë karak-

teristik ishte pjesëmarrja masive e vajzave partizane, ku në ditën e inaugurimit u rreshtuan 50 luftëtare dhe shumë shpejt numri arriti në rreth 200 partizane, të cilat luftuan me trimëri për çlirimin e atdheut. Prenda pak ditëve Brigada u rrit në 670 partizanë nga të cilët 200 nga Gjirokastra dhe mbi 470 nga Vlora e Mallakastër. Në Përmet partizani Mato Mato u takua me 26 bashkëfshatarë fushëbardhas, që ishin rreshtuar dhe luftonin në të njëjtën njësi luftarake si Mehmet Tafil Lagji, Cirok Cama, Guxho Muho, Maksut Muho, Fejzo Kapo, Sako Mullai, Shefqet Golemi, Ramiz Cama, Aqif Bello, Avni Bello, Boço Muho, Baxhul Nora, Rauf Basho, Musto Zani, Lufto Bello, Rabihe Caca, Sako Meçani, Laze Muho, Ramo Nora, Soroush Bineri, Shefqet Deçka, Shega Onjea, Nuri Çarçani, Amzo Muho, Dife Maçi dhe Hodo Basho. Br. XII S në Operacionin armik të Qershorit 1944, përballoi detyra të rëndësishme duke vepruar në terrene të thyera malore dhe në prani të mjaft armiqëve që kishin kapur pozicione të favorshme luftimi si në rrethinat e Berat dhe të Skrapart, në luftime të Tendës së Qypit dhe Qafës së Kiçokut. Luftime të ashpra me pushtuesin nazistë kjo brigadë ka zhvilluar në Tepelenë, Kurvelesh, Vlorë, Llogara, Himarë etj., ku Mato Mato dhe partizanë të tjerë të kësaj brigade shkruan faqe heroizmi e lavdie.

## MITRALIERI PLAGOSET NË TENDËN E QYPIT

Në betejën e Tendës së Qypit plagoset rëndë, por partizani Mato

**K**oha tani është për reflektim. Partizani që u shua nga plagët edhe pse e ka merituar prej dekadash titullin “Dëshmor i Atdheut”, procedurat ligjzbatuese ende nuk e kanë marrë në shqyrtim, njërin prej bijëve të Fushëbardhës, krahinës lavdiplote të Kardhiqit, si dhe krejt trevës së Labërisë, një luftëtarë që plumbi i armikut nuk ja mori jetën në mënyrë të menjëhershme, por gradualisht e bëri invalid dhe i mori jetën

Mato. Ai ishte komandat i togës dhe ishte vendosur në qendër të luftimeve ku dhe forcat armike ishin më të shumta dhe në pozicione të favorshme të terrenit dhe të armatimit. Plaga e tij rridhte gjak, por ai qëndroi deri në fund të luftimit. Ai e arriti ditën e lirisë më 29 nëntor 1944. Mirënjohja dhe nderimi për të rënë në luftë dhe që sollën lirinë e dhanë gjithçka për çlirimin e Shqipërisë nuk rreshti asnjëherë. Mato Mato dhe gjithë luftëtarët e Br. XII S kujtohen gjithnjë nga pasardhësit e veteranëve të partizanëve e partizaneve, nga Organizata e Veteranëve dhe e Dëshmorëve.

Br. XII S, luftëtarët e saj dhe midis tyre edhe Mato Mato shkëlqejnë në gjoksin e atdheut, ata janë nderi dhe krenaria e kombit. Të gjithë dëshmuan dhe treguan trimëri, si dhe mbetën simbole të trimërisë, sakrificave dhe heroizmit në shërbim të Atdheut e lirisë. Prandaj ne kemi detyrimin e respektin e nderimit të tyre, nderimin e gjakut të derdhur për atdhe. Në Br. XII S, luftëtari dhe komandanti i togës Mato Serjan Mato, bashkë me armën e preferuar të tij, mitralozin që se ndau nga dora, qëndruan heroikë në pozicionet e luftimit dhe e kryen me nder detyrën që ju kishte caktuar Atdheu, çlimimin e popullit nga pushtuesi i huaj.

## PLAGË TË LUFTËS QË FLASIN... PËR REFLEKTIM

Pas çlirimit të vendit Mato Mato është vlerësuar nga Min-

(Vijon ne faqen 9)



PROFIL

BURRËRESHA RAMIJE SKUKA, VETERANE E LANÇ-it

Nga Valbona RAMÇE

Ramiye Skuka është lindur në fshatin Fushë e Vogël (Çankë, Kurbeg) në maj të vitit 1919.


Ajo është e bija e Rrahman Skukës. U rrit në një familje me tradita atdhetare. I jati i saj Rrahmani ka marrë pjesë në luftimet kundër serbëve dhe më vonë gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare e ka kthyer shtëpinë e tij në bazë të kësaj lufte.

Ramija u martua në vitin 1938 në fshatin Viçisht me Destan Çup Camin. I vjehrrit i saj Çupi ishte luftëtar në çetën e Fetah Camit dhe ka marrë pjesë në luftimet kundër serbëve në Topojan e Mazhicë në vitin 1913 dhe në luftime të tjera.

Në prill të vitit 1941, Ahmet Cami me shokët e vet të çetës antifashiste sulmuan shtabin italian që ndodhej në Mireshe ku u vranë 50 ushtarë dhe oficerë italianë të Divizionit “Firence”. Pas sulmit ata sollën shumë armatime. Na thanë ne grave të shtëpisë, të fisit që t’i merrnim e t’i fshihnim, tregon Ramija. U mblodhën Bejazja (bashkëshortja e Ahmetit), Nazmija (bashkëshortja e Kurtit), Fitnetja (bashkëshortja e Fasliut), Fija, nëna e Esatit dhe bashkëshortja e Sinanit, Pemja, nëna e Ukës dhe bashkëshortja e Dullës, Razija, bashkëshortja e Ukes, Hajria, nëna e Aqifit, Sadeti, bashkëshortja e Aqifit, dhe e shoqja e Adem Camit dhe i kemi ngritur e fshehur përmbi vijën e ujit, afër Jamishtes, pyllit të lagjes. Kemi mbajtur nga akshami deri sa u gdhi e nesërmja. Ky armatim u përdor nga çeta gjatë gjithë kohës.

Fashistët italianë u hakmorën me ashpërsi. Ata arrestuan dhe burgosën brenda një dite, me datë 19 prill 1941, 19 pjesëtarë të Fisit Cami dhe dy fshtarë nga Tërbaçi, konkretisht: Ahmet Cami, Uke Cami, Dullë Cami, Adem Cami, Islam Cami, Izet Cami, Sulë Cami, Destan Cami, Rremë Cami, Shahin Cami, Tufik Cami, Dilaver Cami, Ibrahim Buziu, Selim Mjeshtri,

Bexhet Cami, Aqif Cami, Hidër Cami, Liman Cami, Taf Cami, Rifat Cami, Hasan Cami. Pra siç shikohet edhe në dokumentin e AQSH, në këtë grup të madh ishte edhe bashkëshorti i Ramiyes, Destani. Numri 118 në këtë dokument është emri i Destan Çup Camit, të shoqit të



kushuriri i Destanit. Dilaveri i Veliut, vëllai i Tafës, ishte i ri në moshë dhe i fuqishëm. Por një ditë gjatë torturave ja përplasën kokën për çimentoje, në murin e betonit të birucës.

Ai dha direkt shpirt pasi goditja që në tru. Drejtoria e Burgut dha njoftim se që një vdekje natyrale dhe se Dilaveri ishte i sëmurë. Ne e dinim shumë mirë se atë e mbytën hetuesit fashistë me torturat e tyre çnjerëzore, tregon Uke A. Cami, një nga të mbi-jetuarit e pushkatimit dhe të burgut, prandaj filluam të vihemi në lëvizje për t’u liruar me çdo kusht. Arritëm të dilnim nga burgu në gusht të vitit 1942.

Por fati i keq e ndolli përsëri Destanin. Në një dasëm në fshat qëllohet pa dashje dhe vdes. Ramija mbeti e ve me barrë në bark. Vendosi të qëndronte dhe të rriste djalin e saj, që e quajti në emër të burrit, Destan.

Së bashku me të vjehrrën Hiken si dhe me njerikën e burrit, Nailen, pra me dy gra të moshuara qëndroi si burrëreshë dhe rriti djalin e saj Destanin.

Gjatë periudhës 1943-1944, shtëpia e saj shërbeu edhe si bazë e Luftës. Vëllezërit partizanë Ymer lleshi dhe Hamdi lleshi (dëshmor LANÇ) ishin nipër në këtë familje. Po kështu Kadri Demiri në Maqellarë dhe Ramadan Mera në Gjoricë kishin lidhje miqësore me këtë familje sepse kishin për bashkëshorte motrat e Destanit. Kushurinjtë e Destanit, Ahmeti, Uke Dullë Cami, Esat Sinan Cami etj mbas daljes nga burgu fashist u rradhitën në rradhët e luftës, ndërsa punën e mbetur në mes, të Destanit, e vijuan nënat, Hike, Naile dhe Ramija.


I Shoqi i Ramiyes, Destan Çup Cami mban titullin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, për pjesëmarrje në lëvizjen Nacional çlirimtare dhe në burgun fashist.

Ramiyes, pas viteve 90, ju njoh kontributi i saj dhe i dy nënave, Hikes dhe Nailes për ndihmën për luftën.

Ramija e rriti djalin e saj Destanin dhe e shkolloi. Destani i ri u bë mësues dhe shërbeu deri sa doli në pension në shumë fshtara të Gollobordës dhe në fshatin e tij, Viçisht. Destani u martua me Naxhijen dhe rritën plot 5 fëmijë, 4 djem dhe një vajzë. Ramija u bë një gjyshe e mrekullueshme për nipërit dhe mbesën e saj.

Ajo u kthye në një monument njerëzor për sakrificat që kreu dhe për kontributin që dha. Nuk ka njeri në fshatin Viçisht dhe në zonën e Gjoricës që nuk e njohu dhe respektoi këtë burrëreshë të pamposhtur.

Ramija vdiq në vitin 2006, por kujtimi i saj kurrë nuk ka për të vdekur.



Faksimile e Arkivit Qendror të Shtetit (AQSH). Numri 118 i faksimiljes është emri i Destan Camit, bashkëshortit të Ramiyes

Luftëtari Mato Mato, akoma nuk ka marrë statusin e “Dëshmorit të Atdheut”

(Vijon nga faqja 8)

istria e Mbrojtjes si “shënjues”, “luftëtar i dalluar” dhe medalje të tjera që tregojnë për trimërinë dhe heroizmin gjatë luftës partizane. Luftëtari i rreshtave të para partizane Mato Mato, ngeli invalid dhe u kthye në fshatin e tij të lindjes në Fushëbardhë, ku ndërroi jetë në moshën 27 vjeçare prej plagëve të marra në luftë. Ai u plagos tri herë, por plaga e marrë në Betejën e Tendës së Qypit, nuk ju mbyll kurrë. Plaga e Mato Matos flet përjetësisht, janë plagë të marra në betejat të luftës për liri e çlirim të Atdheut. Partizani Mato Mato tregoi aftësi për të ndihmuar shokët e plagosur, veti që ia jepte zemërmirësia dhe dashuria për shokët, por dhe aftë-

sia për të mbajtur e transportuar shokët e plagosur si rezultat i fuqisë trupore dhe fizikut të tij, trupmadh dhe i shëndetshëm.

Koha tani është për reflektim. Partizani që u shua nga plagët edhe pse e ka merituar prej dekadash titullin “Dëshmor i Atdheut”, procedurat ligjzbatuese ende nuk e kanë marrë në shqyrtim, njërin prej bijëve të Fushëbardhës, krahinës lavdiplote të Kardhiqit, si dhe krejt trevës së Labërisë, një luftëtarë që plumbi i armikut nuk ja mori jetën në mënyrë të menjëhershme, por gradualisht e bëri invalid dhe i mori jetën.

Është fakt se Mato Serjan Matos rezultonte luftëtar partizan në regjistrin e Komitetit të Veteranëve të LANÇ-it të Gjirokastrës,

me nr. rregj. 424, të pasqyruar nga kryetarja Vera Sako. Ai u shua nga plagët e luftës në moshë 27 vjeçare. Pas la gruan dhe një vajzë të vogël 3 vjeçare, si dhe prindërit. Në më shumë se shtatë dekada Mato Mato është nderuar si luftëtar i rreshtave partizane njësoj si dëshmorët nga strukturat në Tiranë e rreth, por ende nuk i është akorduar statusi i merituar “Dëshmor i Atdheut”. Në çdo 5 maj familja e tij nderohej e respektohej si gjithë dëshmorët e tjerë. Gjykojmë se është koha të jepet titulli i lartë i merituar dhe i shenjtëruar “Dëshmor i Atdheut”, titull që e ka merituar prej kohësh. Luftëtari partizan Mato Mato që luftoi, për atdhenë është dhe mbetet dëshmia e plagëve që rrjedhin ende gjak...



## SPORTI

# Në vazhdim të sagës së “Pasionit të bardhë”

**Dr Leonidha Peppo\***

Ende nuk është shuar jehona e aktiviteteve dimërore dhe përshtypjet shumë pozitive të olimpiadës të Koresë, por edhe të shqipëtarëve të cilat na interesojnë të gjithëve, siç ishte kampionati në Shishtavec të Kukësit, ku e pranishme pak para garave ishte edhe ambasadorja e OSBE, Romana Vlahutin, e njohur tashmë për të gjithë zhvillimet e rëndësishme të vendit tonë, duke dhënë vlerësim pozitiv të bjeshkëve dhe maleve të zonës përreth. U zhvillua edhe kampionati shqiptar në dy faza për fëmijë dhe të rinj dhe të reja në zonën shqiptare të Kosovës, në fshatin Brod në kompleksin “Arxhena”, ku me kujtohen pronarët 3 vëllezërit, Naseri dhe 2 të tjerë dhe menaxherja Liljana shumë e sukseshme në detyrën e saj për mbarëvajtjen e këtij kompleksi jo e lehtë për të arritur e administruar. Në këtë kompleks, pra në verë ka pamje të mrekullueshme të boronicave e luleve të pemëve, shkëmbinjtë me ngjyra të ndryshme vezulluese nga dielli qëndrojnë si kurorë në këtë luginë duke ja dhënë pushuesve dhe turistëve të shumtë entuziasmin dhe gëzimin që çdonjëri ka provuar.

Por le të kthehemi tek garat e kampionatit kombëtar të organizuar nga Federata Shqiptare e Skive, në bashkëpunim të ngushtë e të sqjertë me Federatën e Skive të Kosovës, me eksperiencë shumë të madhe për organizimin dhe mbarëvajtjen e këtyre garave qysh nga zgjedhja e shtegut, siç iu thonë atyre, pra pista por edhe vendosjen e shkopinjve që krijojnë portat e detyrueshme të kalojnë garistët tek rregjistrimi elektronik, te kohëve të arritura nga skiatorët, duke shmangur keqkuptimet dhe rezultatet e arritura ndaj të pranishmëve; tek starti automatik deri tek mjekje me mjetete e nevojshme në rast të lëndimeve që janë të pranishme në të tilla ngjarje.

Kjo ndodhi në fakt, kur një vajzë nga Korça që garonte dhe ndihma ju dha në cast nga persona të mirëtrajtuar por edhe të tjerë vullnetarë të gatshëm të ofronin gjithçka dinin, me motora bore e ndihmë fizike apo mendore. Çdo gjë vajt mirë, pavarësisht ndikimit të keq të motit në ditën e garave, ditë e dielë me fortunë e dëborë me fjalën suferinë. Por kjo është kuptimplotë në këtë rast, duke ngadalësuar dhe penguar cilësinë e garave, por edhe të tjerët që duan të përformojnë për kënaqësinë e tyre me sh-

kallë vështërsie të ndryshme të pistave në dëborë.

Gjithsesi, çdo vështirësi e përkthyer apo përshtatur në drejtim të njerëzve quhet pasion dhe kënaqësi për çdo sukses dhe kemi çfarë të tregojmë siç po bëjmë edhe me këtë shkrim, për t’u dërguar mesazh njerëzve dhe sportdashësve se kështu ndodh gjithmonë: pa u thyer, pa u tërhequr përpara pengesave për të arritur qëllimin që ke përpara! Në këto kushte u zhvillua kampionati Kombëtar i skive për të gjitha moshat, duke u ndarë në dy grupe, të vegjlit, moshë feminare në distancë të reduktuar kurse pjesa tjetër me pistën e plotë me grup moshë të ndryshme. Gara që e hapur për pjesmarrje të gjërë e të lirë. Duhet përmendur dhe falenderuar pjesmarrja e Federatës së Skive të Kosovës me figura të larta të saj. Kurse pjesmarrësit në gara, pra sportistët e Kosovës ishin me cilësi jo të lartë për nivelin e tyre maksimal, por gjithsesi shumë më të lartë se garistët tanë. Kjo është e vërteta, Sigurisht është frut i investimit dhe kushteve klimaterike të zonës së Shqipërisë, sigurisht edhe këtij të kufirit, si në Dardhë me inisiativë private dhe pasionante ku ka pistë të rregulluar dhe sistemuar me ngjashmëri me atë që kemi parë me shumicë edhe në vendet e Europës. Përpjekje të admirueshme bëhen edhe në Shishtavec nga njerëz kurajoz e pasionantë, por mungon infrastruktura e mirë dhe funksionante për komodite-

tin e sportistëve dhe qeflinjve të malit e dëborës, kurse Voskopoja e famshme për të cilën kam shkruar një artikull me titull “Qyteti i skive shqiptare” tashmë është kthyer në vend të sukseshëm turistik, por i harruar për sportin e skive.

Një burim i mirë për skijim është edhe Puka, ku përpjekja e mjeshtrit alpinist Përparim Laçi nuk ka arritur të bëjë pistë funksionante për popullin e saj.

Sidoqoftë Federatën e Skive ka bërë të mundur zgjidhje të tjera si kjo që shkruajta më lart në sajë të presidentit Shpëtim Mema (Guxho) të lidhet me kryesinë e Federatës të Skive të Kosovës, me ndikimin logjistik të tyre dhe me pjesmarrjen e sportistëve, të zhvillojnë me plot sukses gara edhe në kushte të vështira atmosferike, sigurisht të ndihmuara nga Dr.Kliti Hoti që ka emrin e djalit të mbretit Gent të Arbërisëm si edhe me mbështetjen e rektorit të universitetit të Sporteve z. Agron Cuca, Ana Burda me familje sportive nga Korça, e njohur si skiatorë shumë e mirë në kompleks. Evidente ishte edhe mbështetja e Ministrisë së Sporteve që na siguroj për zhvillimin e këtij sporti si mbreti absolute i gjithë sporteve.

Duhet të përmenden ekipe të Korçës, Shishtavecit, të Borjes me udhëheqës pasionant si Shair Dokle të Tiranës, me prindër mbështetës si Arben Banka, Shkëlqim Dobi, Rishan Parllaku - nje siguri për të ardhmen e fëmijëve në këtë

sport . Mungesë ishte një kampion i njohur para 30 vitesh në vrapimet e gjata i quajtur Azem Basha.

Ky investim më parë i bërë nga Maqo Tasho në Dardhë të Korçës merr frymëzim shumë më herët ka qënë atlet, skiator vrapues për kohë të gjatë .

Emrat e përmendur më sipër siguruar traditën dukë bërë skiatorë shumë të mirë fëmijët si Bora Mema , Marina, Paula, Erald Parllaku Parid Dobi, Endrin Hoti etj.

E papritur për në mbledhjen e përbashkët me Federatën e skive të Kosovës, ishte çasti kur këta të fundit kishin përgatitur medaljon për garuesit; fillimisht për më të mirën por edhe për të tjerët. Këto ilustrohen dhe me fotot që shoqërojnë artikullin, duke ngazëlluar edhe fëmijët si shpërblim për mundin e stërvitjes së tyre.

Në biseda, në momentet e mbledhjes përmblylëse, ku u ndanë edhe çmimet e medaljet u përmend edhe emri i Milorad Mereniqi, që krahas të tjerëve i dha shtysë në vitet 60-70, zhvillimit të sportit të skive.

Dhe çmimet u ndanë sipas grupmoshave që për çudinë tonë i caktoam me emra nga të zotët e shtëpisë sipas grupmoshave

## GRUPMOSHAT

### Fatosat 1 :

Ronald Beqiraj (Kallabak)  
Marin Banka (Tiranë)  
Noel Vasi (Tiranë)  
Daniel Dokle (Kallabak)

### Fatosat 2:

Lukas Mici (Skënderbeu)  
Elam Rama (Shishtavec)  
Larje Hoxha (Shkodra –sport)

### Pionerët e rinj:

Klajdi Alilaj (Kallabak)  
Erdin Hoti (Shkodra- sport)  
Juniorët e renj:  
Mathjeu Koço (Skënderbeu)  
Artenis Bela (Shishtavec)

### Juniorët e Vjetra

Genta Hoti (Shkodra –Sport)

### Seniorët :

Kudret Beça (Shishtavec)  
Dizen Bala (Shishtavec)  
Nertil Behluli (Kallabak)





PROMOVIMI

Antologjia e mendimit të sotëm për Mirditën

Këto ditë u promovua në Muzeun Kombëtar, “Salla e Uneskos “botimi i mirëpitur “Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën”i autorit të mirënjohur Gjon Marku.

Drejtuese e veprimtarisë ishte Suela BALAJ, Drejtoresha e Bibliotekës Lezhë, e cila moderatoi me kulturë dhe seriozitetin e duhur për një auditor të gjërë intelektual mirditas, tiranas e më gjerë kolegë, shokë , miq dhe intervistues , botuar në Antologji (në të dy vëllimet), si edhe mjaft lexues të zellshëm të veprave të autorit. Prof. dr. Mark Tërta, akademik, pohon se ” Për herë të parë shohim një botim, ku gërshetohet dija, mendimi e mençuria. Këtu është realizuar një libër i papërsëritshëm deri më sot.”

Dr. Nikollë LOKA, në kumtimin e tij u shpreh për këtë botim :”Antologjia për mendimin e sotëm për Mirditën, është enciklopedi e plot për Mirditën”.

Prof. dr. Fejzulla GJABRI, i intervistuar ( vll. II, f. 324 ) thekson se “Do të mjaftonte pohimi i Kadaresë për të treguar vlerat e këtij libri, i cili e quan: “Pasaporta e munguar për Mirditën.”

Po kështu edhe Prof. dr. Shefqet HOXHA thotë se “ Kjo Antologji është botimi më i mirë i shkruar për Mirditën.

Studiuesi Martin Deda e përmbyllë mendimin e tij me këtë frazë: “Gjon Marku i dha Mirditës botimin më të plotë, më të saktë e të vetmin me përmasat e një enciklopedie reale për Mirditën.”

Autori Gjon Marku me këtë “Antologji”(botuar Vëllimi I,2009, Vll. II, 2014) i bën shërbim të çmuar Mirditës me pasurinë e mendimit të sotëm” që sjellë për këtë krahinë me histori, arkeologji dhe etnokulturore të pasur.

Kjo “Antologji” të tillafvll I e II ) forcojnë dashurinë për vendlindjen, duke plotësuar e thelluar njohuritë mbi te dhe përmëtepër shërbënë për studime të më tejshme të fushave të ndryshme; njëkohësisht është edhe një model edhe për krahina të tjera shqiptare të njohura në shkrime më pak se faktet e dokumentuara.

Ky botim me kaq intervista , është “një libër bashkëbisedimor” me personalitete të kulturës historike dhe artistike. Gjithashtu është një prurje me interes për studimet albanologjike;

Në këtë “Antologji” pasqyrohet mjaft mirë bashkëpunimi me interes shkencor e kulturor mes autorit dhe intervistuesve me shtrirje brenda e jashtë atdheut;

Gjon Marku , i njohur , së pari , si letrar me tregimet “Njeriu që vinte dhe ikte natën”(1999) dhe “Varri nën dardhë”(2004) ka bërë emër të mirë edhe me monografitë: “Ndërfana”(2001 ribotim 2008), “ Mirdita në vizionin filatelik”(shqip e anglisht, 2004), “Mark Legisi – Një jetë midis nxënësve” (2008).

Së dyti, sado që me gjithë këto botime, u bë edhe më i suksesshëm me publicistikën: “Mirdita – intervista” në tre vëllime (I-2000, II-2002, III-2004), ribotim-2009 në mbi 700 faqe me një titull mjaft të gjetur: “Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën”.

Edhe krijesi e studiuesi i mirënjohur edhe redaktori i këtij botimi Ndue DEDAJ, na e prezantoi me një titull mjaft domethënës “ Përmasë një botim “ndryshe” për Mirditën”. Për më tepër e merr për “ një libër bashkëbisedimor” të “ një natyre të veçantë” ku mjaft “ emra të përzgjedhur” si të ishin rreth një tryeze të mendimit kulturologjik kanë folë në vlerë të një emri, MIRDITËS.”

Sa më sipër vlerëson veçan autorin “Gj. Marku për përpjekjet e tij , përkushtimin, vullnetin për t’i kërkuar, për t’i gjetë, për t’i afruar “ si në një forum të lirë” për t’u marrë mendimet, kujtimet, mbresat, opinionet e interpretuesve për Mirditën, për një prej krahinave me veçori karakteristike të trojeve shqiptare, për ndihmesën e dhënë në përpjekjet për mbrojtjen e interesave kombëtare, krahas lirisë dhe identitetit të etnisë shqiptare.Me aftësinë e një bashkëbiseduesi, që në mënyrë mjaft shoqërore e miqësore, ka arritë t’i shkëpus intervistuesit prej detyrimeve të veta dhe t’i njoh me tematikën e pyetjeve që ka përgatitë që më parë. Por edhe kur nuk ka gjetë përgjigjen e mjaftueshme, prapë ka përdorë pyetje shtesë apo plotësuese për ta orientuar më mirë për përgjigjen e tij ose për t’u nxitë që ta ndajë veten më të gatshëm për ta çuar mendimin e hedhur deri në fund.

NJËQIND INTERVISTA PËR MIRDITËN

Nga këta intervistues vetëm rreth një e treta janë mirditas apo me origjinë prej Mirdite. Dy të tretat, pra rreth 40 të tjerë, nuk kane lidhje origjine me Mirditën. Kështu që mendimet e tyre duhen pranuar mjaft objektive.

E themi këtë, sepse, jo se ata që janë mirditas, apo me origjinë sish , janë më pak objektiv apo janë subjektiv, por meqë kanë të bëjnë me vendlindjen e tyre, janë shpreh nga të tjerë opinione të tilla.

Le të njihemi me disa prej të intervistuarve, duke u ndalë për mendimet dhe idetë kryesore që kanë dhënë për Mirditën, me vlerësimet për të , të para në lidhje edhe me Mat, Pukë, Shkodër deri me Dukagjin dhe Kosovë. Në ndonjë rast kanë shpreh edhe verëjtje për këtë kra-



GJON MARKU

hinë me peshë.Reshti i bashkëbiseduesve nis me një klasik të letërsisë shqipe, prof. Dhimitër SHUTËRIQIN i cili një kohë qe bërë “mirditor” . Ai e pat kthyer Mirditën në një laborator kërkimor në vitet ‘60, me “Kalanë e Judejve” dhe gjetjeve mbishkrimore ( të hulumtuara fillimisht prej prof. M. Tërta - Xh. Meçi), që e çonin Mirditën në shek. XIII. Vijnë pastaj të tjerë personazhe nga më të shquarit e botës shqiptare:

Prof.dr. J.Kastrati , një studiues i përmasave akademike, e quan Mirditën “ një minierë thesareshe në historinë tonë Kombëtare”, sepse “Mirditën e kam njohur përmes dokumentash të shumta që kam kaluar nëpër duar prej 60 vjetësh.”

Për më tepër prof. J.Kastrati na bën të njohur edhe një gjykim të Jeronim de Radës për abat Prend Doçin, të cilin J. de Rada e cilëson si “ një nga karakteret(personalitetet) më të spikatura, më të shquara shqiptare”. Në vazhdim, shkruan se si ndihmoi në kryengritjen e Mirditës të vitit 1875, si u zu rob në Guci. Më pas, si u lirua, si ndej i arratisur “ pesë vjet në Amerikë, e pastaj në Athinë aq kohë sa i mjaftoi për të njohur pabesinë e grekëve”. Prof. J. Bullo, akademik, Prend Doçin e çmon shumë se “është një veprimtar dhe poet i fillimeve të Rilindjes ,një nga ata, që me veprimtarinë dhe krijimtarinë e tij u hapën udhën proceseve të njësimt e të integritimit të kulturës së Rilindjes”.Këtë veprimtar dhe krijimtari të abatit P. Doçi ai e shpjegon të lidhur me Mirditën. Por, duke folur për këtë kontribut të Mirditës, prof. J. Bullo, nënvizon edhe faktin se në kuadrin e studimeve të historisë së letërsisë së Rilindjes qoftë edhe “personalitete kombëtare si Abati i Mirditës Prend Doçi, nuk do të lejohej ta shihja atë sipas kufijve krahinor.”(F.332).

Edhe arkeologu N.Ceka, prof. dr., e merr Mirditën të lidhur me Luginën e Matit dhe të Drinit(Pukës), sepse së bashku “ishin boshti i Arbërit të hershëm”.(F.400).

Antropologu A.Dhima, prof. dr., duke u ndalur në vlerësimin e varrezës arbërore të Prosekut thekson se “Paralelet më të afërta në pikëpamje antropologjike”.. i ka me varrezën e Komanit(shek.VI-VIII), “në rrethin fqinj të Pukës”. Dhe se studimi i tyre në tërësi “ solli të dhëna të vlefshme... të formimit të etnosit arbëror në veri të vendit.”(F.525,526).

Akademiku M.Krasniqi, sado që e merr Mirditën si krahinë me shumë interes studimi, prapë e kundron në kuadrin e Malësisë: “Mirdita si e gjithë Malësia është një trevë e gjerë me shumë interes për studiues të fushave të ndryshme shkencore.”(F.70).

Studiuesi Sh.Hoxha, profesor, kur ndalet te Kanuni shprehet qartë se si Kanuni i Mirditës, si ai i Lumës, “janë krijesa të së njëjtës popullsi”, por që shprehin në tërësi “pamëdyshje unitetin kombëtar”.(F.242). Në këtë vështrim nuk mund të këmbëngulet se “Kanuni ( Lekë Dukagjinit)u ngjis kryesisht në Mirditë”.(F.61)

Me gjithë respektin që kam për autorin I.Elezin dhe për dr.P.Doçin, tashmë është një realitet se “ Kanuni i Mirditës, mbledhur dhe kodifikuar nga studiuesi eksplorues Xhemal Meçi, përbën një arritje të shënuar në kërkimet shkencore të etnologjisë juridike shqiptare, M.Tërta, Parathënia, Xh.Meçi-K.L.D. në variantin e Mirditës. Tiranë, 2002, f.17)

Me shumë interes është intervista e M.Zeqos, “ Mjeshtër i Madhi Punës”, i cili kumton se në kishën katedrale të Gëziqit( vitet 1190-1216)” nuk (duhet) të harrohet që të theksohet se “ i blatohet kombit të denjë”(Dikae Nationi) që do të thotë se “kemi në realitet dëshminë më të hershme për ndërgjegjen e shqiptareve për strukturën etnike si komb”. Dhe këtë dëshmi të jashtëzakonshme e ruajt për shekuj kisha e Gëziqit të Mirditës, por M. ZEQO thotë se Mir-

dita më intereson si Shqipëri në këtë suazë të pambyllur... gjallon universaliteti i saj.”(F.503).

I kësaj ideje është edhe redaktori i këtij botimi Nd.Dedaj, por më i mbledhur, në një kënd më të ngushtë, gjithmonë me përparësi të veçantë për Mirditën: “Në rastin e Mirditës, boshti, konstrukt apo korpusi i saj etnologjik dhe historik , ashtu si i zonave përreth (Kurbinit, Matit, Lurës, Pukës, Lezhës, Dukagjinit etj) është ai i një ngrehinë madhore, pasqyrë e gjallë e së vjetërës shqiptare, autentike në botën e maleve, si edhe e risive dhe progresit kulturor të saj.”(F.14).

Studiuesi i mirënjohur V.Kamsi vë në dukje lidhjet Shkodër-Mirditë. Shkodra u bë qendra kryesore, ku personalitete të Mirditës të fushave të ndryshme gjetën strehë, ndërtuan edhe shtëpi apo kullë dhe u përkrahën fuqishëm edhe në veprimtaritë e tyre kulturore, arsimore dhe atdhetare.

Njëkohësisht, ky intervistues nënvizon edhe faktin, se “përhirë të së vërtetës” prej mirditasve qe praktikuar edhe ( cubnia) “ me përvetësimin e pronës së huaj”. Gjithashtu edhe merce-narizmi (shërbim ushtarak me pagesë) deri në luftën e Krimesë.” Për raste si këto pohon se lidheshin me përpjekjet për mbijetesë” me varfërinë e tyre të skajshme.”(F.126).

Mark Marku , poet e studiues i letërsisë, pedagog i Gazetarisë në Universitetin e Tiranës, është i mendimit se Shkodra në çdo kohë ka qenë qendra kryesore e zhvillimeve kulturore dhe atdhetare në Shqipërinë e Epërme dhe më gjerë.

Si vlerëson “rolin e kishës dhe klerit në krijimtarinë e kulturës, letërsisë dhe vetëdijes kombëtare nënvizon faktin se qendra e këtyre zhvillimeve nuk ka qenë as Mirdita e as Lezha , por ka qenë Shkodra.”

Njëkohësisht , M.MARKU për zhvillimin e letërsisë shqipe në fillësën e saj e në vazhdim shprehet se “Është fat që, duke qenë një letërsi e krijuar dhe e formuar në fillësën e saj nga priftërinjtë, kultura shqipe lind si perëndimore dhe formësohet si e tillë.” Por ndryshe nga një prirje në “Antologji” për të vlerësuar vetëm rolin e kishës dhe të priftërinjve katolikë me qendër kryesisht në Mirditë, M. Marku nuk le pa përmendë edhe faktin e rëndësishëm se “edhe elementi mysliman që ka ndikuar kryesisht në periudhën e Rilindjes (vëllezërit Frashëri e Konica), i janë bashkuar pa asnjë ngurrin kësaj rrjedhe dhe kanë kontribuar në konsolidimin e konstantes perëndimore të kulturës sonë”(f.731) Edhe prof.J.Kastrati sado indirekt, një paralele të tillë e heq edhe për arbëreshët e Italisë, të cilët,ndonesë nuk qenë të kishës romane katolike, por ortodokse, nuk pushuan kurrë për kulturën, gjuhën dhe çështjen kombëtare: lirinë e pavarësinë e saj. Prandaj, jo rastësisht, intervistën e përqëndroi te “Topografia e Lezhës nga Prenkë Doçi,” botuar te “Fjamuri i Arbërit” të J.de Radës. Dhe ky personalitet madhor arbëresh shkruan vlerësimet më dashamirëse për abatin katolik,P.Doçin, sepse Ai nuk kishte komplekse kishash e klerikësh, por vetëm arbëreshësh shqiptarë. Duke e parë si të tillë një poet i shek.XX krijoi vargjet brilant për Te: “Atë që ç’ka bëri Skendërbëu me shpatë/Ti e bëre me penë, o i madhi De Radë!

Gjithashtu edhe poeti i madh i Rilindjes dom Ndre Mjeda, të cilin ,

Po e nxjerrë nga harresa studiuesi i shquar Mentor Quku, pozicioni i tij në veprimtar dhe poezi ka qenë gjithmonë Shqiptaria:

-“Nji nan tjetër, -thoshe,-ke/ Bir n’ket dhë,/ Nana jote a’ Shqiptaria!

Pra, kryesorja nuk qëndron në atë se cila krahinë është vendlindja e të parëve të tij, në se është Puka apo Mirdita.Ashtu edhe për gazullët

e famshëm, fisnik rëndësi ka roli i tyre për kulturën shqiptare, për çështjen shqiptare në tërësi.Kryesorja-janë shqiptar sepse kryesorja për ta qe “Shqiptaria”.

RIBOTIMI ME TË REJA SHKENCORE

Në ribotim nuk mjafton riprodhimi fjalë për fjalë i materialit të botuar vite më parë, sepse, një ribotim serioz, duhet t’i marrë parasysht arritjet e reja shkencore, aq më tepër, kur këto botohen, siç është rasti “Mjeda 1” botuar 2004, kurse intervista e studiuesit me përmasa akademike prof. M. Quku është botimi dy viteve më parë(Mirdita-intervista II Tiranë, 2002).

Sidoqoftë , ky “ribotim” pa redaktim duket se është bërë me qëllimin e mirë që përgjigjet të ribotohen të plota dhe, në të ardhmen, siç nënvizon redaktori Ndue Dedaj: këtë përmbledhje e mendojmë si një libër të hapur, të papërfunduar.. me atë që nuk është thënë..(Parathënia, f.16)

Me këtë qëndrim të shprehur qart dhe në formë ftese i lind e drejta në të ardhmen si një studiuesi apo studenti, “që e përgatit diplomën”. Kështu që kjo, “Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën” dhe më gjerë, do të shërbejë edhe në të ardhmen “ si në një forum të lirë”, ku të kumtohen “idetë, mbresat dhe gjykimet e tyre.” Për të arritë në përfundime më të plota e më të sakta duke u çliruar, aty ku duhet, nga “romantizmi” krahinor deri në “mbretërinë e maleve shqiptare”.

Shembulli i profesorit M.Tërta, akademik, mbetet model si për autorë mirditas, si për studiues të tjerë, sepse, sado që shprehet me dashuri të madhe për Oroshin, vendlindjen , dhe Mirditën si krahinë e vendlindjes së tij, gjithë veprimtarinë e tij të madhe shkencore i lidh me universin shqiptar, në shërbim të tij, sepse : “Puna për interesa të kombit shqiptar s’më lodh kurrë” .(“Republika” .Tiranë, 29 qershor 2011, Studiuesi Nd. Dedaj thekson se lexuesit shqiptar kanë për të gjetur në këtë antologji ( I, II) të shkruarën me dritëhijet e veta, si dhe ftesën për të sotmen, që nuk mund të kryhet nga një “grusht” mirditas që kanë mbetur sot në trojet e të parëve, por nga gjithë komuniteti i kësaj treve i shpërndarë deri ...në emigracion. Ndërsa lexuesit e huaj bashkëkohorë kanë për të gjetur arkaiken dhe fillesat e një shoqërie moderne në brigjet e Fanit të Madh e Fanit të Vogël...se kronika e jetës së këtyre vendeve nuk ka qenë gjakmanja, por e kundërta e saj - Fjala e Dhënë.( Nd. Dedaj, Njëqind intervista për Mirditën, II, Tiranë, 2017, f. 16-17).”Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën, II/2017 vjen si një vazhdim i vëll.I/2009,që pasuron më tej, jo vetëm me emra autorësh të intervistuar, por edhe me dëshmi të reja panoramën historiko-kulturore të kësaj treve( Nd. Dedaj , po aty f. . 27). E nderuara Leze Spaci, aktore e teatrit të Prishtinës shprehet: “ky libër (Antologji...) duket si një amanet që brezat ia lanë e ky do t’ia lejë brezave të mos e preki askush, pse është e shenjtë. Nd. Dedaj (po aty f. 17.) në mbyllje vjen në përfundimin se”Antologji e mendimit të sotëm për Mirditën” është një botim me vlera shkencore, një model dhe një ndihmesë që, me pasqyrimin historik, etnologjik si edhe i fushave të tjera në botime të tilla për vendlindjen, shërben si një fjalor enciklopedik, ku secili e gjenë më të plotë pasqyrimin në tërësi të krahinës së tij ose krahina me inetres të veçantë studimi siç ka vepruar N.Dokle për Lumën apo IKP(Akademia e Shkencave)Shpati i Sipërm”, Art Klub- Ulqini në rrjedhat e kohës” etj .

Xhemal Meçi, studiues “Mjeshtër i Madh





## INTEGRIMI

## WE Are NATO – Ne Jemi NATO

Halil RAMA

(Vijon nga faqe 1)

NATO e ka përforcuar shumë mbrojtjen kolektive mbi bazën e nenit 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, ku sulmi ndaj një vendi anëtar konsiderohet si një sulm ndaj të gjitha vendeve anëtare. Ajo po jep gjithnjë e më shumë një mesazh të qartë se e ka të gjithë potencialin për t'iu përgjigjur çdo lloj kërcënimi.

Por problem kryesor është se kërcënimet sot janë të papritura dhe në forma nga më të ndryshmet, të cilat mund të shkaktojnë të njejtat fatkeqësi e dhimbje, njësoj si një agresion i armatosur, siç janë kërcënimet hibride apo kibernetike.

Në leksionet publike në shumicën e universiteteve dhe viteve të fundit të shkollave të mesme në të gjithë vendin është synuar qartësimi për shtimin e ndjeshëm dhe kërcënimin serioz që përbëjnë për sigurinë e vendeve anëtare të NATO-s sulmet e vashdushme kibernetike, terrorizmi, tentativat për trafikimin e elementeve dhe metarialeve që shërbejnë për prodhimin armëve bërthamore dhe të atyre të dëmtimit në masë. Kjo edhe për faktin se në luftat e sotme drejtimi dhe kontrolli nuk mund të kryhen pa një rrjet kibernetik të sigurtë. Për këtë arsye NATO ka marrë të gjitha masat dhe ka rritur aftësitë për të mbrojtur rrjetet e saj ndaj çdo lloj kërcënimi. NATO njëkohësisht ndihmon vendet aleate për të modernizuar dhe mbrojtur rrjetet e tyre kombëtare, jo vetëm ndaj infrastrukturës ushtarake por edhe ndaj asaj civile, sidomos në fushën e energjitikës. NATO tashmë ka vendosur që në rast të një sulmi kibernetik ndaj një vendi anëtar, në rast se gjykohet e nevojshme, mund të vihet në zbatim edhe



neni 5 i Traktatit të Uashingtonit.

Pjesë e rëndësishme e leksioneve publike të personaliteteve dhe specialistëve të spikatur në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, nga NATO dhe vendas kanë qenë dhe statistikak, sipas të cilave

“Aleanca ka trefishuar madhësinë e Forcës së Reagimit të shpejtë në 40,000 trupa, në gadishmëri dhe e aftë për të vepruar brenda një kohe shumë të shkurtër. Ajo ka shtuar stervitjet ushtarake si dhe ka zgjeruar policinë ajrore

në rajonet e Detit Baltik dhe të Detit të Zi. Janë vendosur gjithashtu rreth 5000 trupa në katër grupe luftarake shumëkombëshe në lindje të Aleancës”. Personalitete dhe specialistë të spikatur në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, kanë vlerësuar faktin se Struktura e Komandës së NATO-s po përditësohet dhe modernizohet për të mundësuar që të lëvizin forcat më shpejt në të gjithë Evropën dhe të mbahen të lira dhe të hapura linjat e komunikimit në të gjithë zonen euro-Atlantike.

NATO ka dhënë një kontribut themelor për paqen dhe sigurinë në Ballkan, por veçanërisht për çeshtjen shqiptare dhe pavarësinë e Kosovës. Ajo vazhdon të jetë prezente akoma në Kosovë, me afro 4600 trupa, një forcë kjo paqeruajtëse ndërkombëtare e cila përgjigjet për ruajtjen e një mjedisi paqeje në Kosovë.

Studentëve dhe nxënësve u është bërë e qartë se si funksionon pjesmarrja në operacionet luftarake të NATO-s si dhe niveli i pjesmarrjes së Shqipërisë në to. Deri më sot kanë marrë pjesë gjithsej 7000 ushtarakë, të forcave tokësore dhe 150 të forcave detare, si dhe vazdojnë të kryejnë detyra në operacione dhe misionone ndërkombëtare, në Afganistan, Letoni, Kosovë, Bosnjë Hercegovinë, Detin Egje, dhe Mali.

Shqipëria ka dëshmorin e saj, Kapiten Feti Vogli, vrarë me 21 shkurt 2012 gjatë misionit luftarak në Herat në Afganistan. Në 6 – vjetorin e rënies në krye të detyrës, në shkurt të këtij viti, dëshmori i atdheut kapiten Feti Vogli u nderua edhe në vendin ku ai dha jetën, në Afganistan. Fotografia dhe vepra sublime e kapiten Feti Voglit u vendosën në Hollin e Trimërisë (Muri i të Rënëve) në Kabul, mes ushtarakëve të NATO-s të rënë në krye të detyrës.

## HOMAZH

## LAMTUMIRË MIKU YNË I PAHARRUAR – ARTISTI AGIM KAVAJA

SHPENDI TOPOLLAJ

Në vjeshtën e vitit 1961, kur nga dritaret e shkollës “Skënderbej”, shihja një grup studentësh ushtarakë që me një krenari të dukshme qenë kthyer nga studimet e lëna përgjysmë në ish B.S. nuk kisha si ta dija se midis tyre, fati do ta sillte që njërin, studentin e inxhinierisë Radio - elektronike të shkollës “Popov”, Agim Kavajën, ta bëja më pas shokun nga më të dashurit dhe pas afro 60 vitesh, do kisha barrën e rëndë, por dhe nderin e madh që t'i mbaja fjalën e lamtumirës, kur zemra e tij e mirë dhe e lodhur do pushonte së rrahuri përgjithmonë. Djalë i vetëm i dy prindërve të mrekullueshëm antifashistë, Palit dhe Roksanit, Agimi qysh i vogël kaloi ditë dhe net maleve mes partizanëve, ndaj dhe asnjëherë nuk iu fashit besimi se epopeja e luftës nacional - çlirimtare qe faqja më e lavdishme e historisë tonë. I urtë dhe i qetë, madje dhe tolerant në biseda, përherë me fjalë të mençura, ai jo vetëm kishte si moto fjalët e arta të Dantes se “Asnjë të mos harrojë se asht njeri: / ju le nuk keni për t'gjallue si shtasë, / po për të ndjekë virtut e dituni.”, por dhe larg çdo arrivizmi e karrierizmi, i zbatoi ato më së miri në jetë. Kudo që u



caktua të punonte, qoftë dhe në detyrën më modeste në muzeun Arkeologjik, ai jo vetëm u kulturua pareshtur, por edhe u shqua si një njeri i thjeshtë dhe i përgjegjshëm, përherë i gatshëm të ndihmonte këdo që kishte nevojë. Kishte mësuar mjaft mirë gjuhën ruse atje në Leningrad (sot San Petersburg), kishte vizituar me

etjen e njeriut të interesuar për çdo gjë, muzeumet e famshme të atij qyteti, pra artin e papërsëritshëm në përgjithësi, dhe atë të pikturës në veçanti, ku e shtynte talenti i tij i spikatur dhe studimet në Liceun Artistik, dhe duke lexuar gjithçka i binte në dorë, ai arriti të ngrihej në nivelin e një intelektualit të respektuar të qytetit tonë. Veprat e tij në pikturë, fotografitë e shumta dhe sidomos përkthimet që bëri, janë rezultat i një vullnetit të pashoq, por edhe tregues i formimit të tij qytetar. Mjaft të kujtoj sot, se novelat e Xhek Londonit, të pabotuara më parë, u zgjodhën prej tij, me një intuitë të rrallë, pasi ato pasqyronin karikaturën nga na u desh të kalonte demokracia jonë. E joshte filozofia, e sidomos ajo e lashta, ndaj dhe u mor deri me brahmatizmin, siç vërehet dhe nga libri i përkthyer prej tij BHAGAVAD GITA, poema epike indu. Por sidoqoftë, midis atyre dy sistemeve që parashtronte në kohën e tij Lukreci, pra stoicizmit, që kupton besimin në fuqitë e mbinatyrshme dhe epikurizmit, ai preferonte këtë të fundit, ku njëri mbetet zot i fateve të veta, çka mbetet dhe përcaktues i mendimit të pavarur e përparimtar. Ëndërronte edhe kur sëmundja e gjatë e mendoj, duke i qëndruar pezull

si ai shkëmbi i zhurmshëm i Tantalit, që ta shihte të botuar dhe Kontin Lukanor të Huan Manuelit, por nuk arriti. Atë, duke e marrë si amanetin e tij, do t'ja realizojmë ne, fatkeqsisht post mortem. Por kot flas për vdekjen e njerëzve të virtytshëm si Agim Kavaja, pasi ai qe model edhe si familjar. E adhuronte dhe e nderonte deri në fund nënën e tij. Zbatoi me gruan e tij atë thënien e Servantesit se “Bashkëshortët e mirë, kanë dy shpirtra, por një vullnet”, gjë që e vërtetoi dhe shërbimi i saj dhe kurajua që Frosina i dha deri në çastet e fundit. E mbi të gjitha, ata së bashku rritën dhe edukuan Pavlin zemërmadh, Andin dinjitoz, të dy artistë, dhe Roksanën e zgjuar. Dhe tani, në mbyllje të kësaj fjale, në nderim të passionit të mikut tim që e pashë për herë të parë atë ditë vjeshte të rreth 60 viteve më parë, lejomëni t'u them se Agim Kavaja, qe për mua i denjë për ato fjalët e Kalimaskut “Mbi varrin e Saonit”, ku thosh: “Këtu ka rënë në gjumë të shenjtë Saoni... Mos thuaj “Vdiq” për njëriun e mirë.” Gjurmë të lehtë edhe ty, o i miri dhe i shtrenjti ynë Agim, këtu në gjirin e prindërve të tu, por që s'arritë t'i shohësh dhe një herë Andin dhe Roksin tënde të vogël! I paharruar qoftë kujtimi i tij!